



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KRYEMINISTRIA INSPEKTORATI QENDROR

### MESAZH I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2018, Inspektorati Qendror, ka përbushur detyrimin ligjor për vendosjen e veprimtarisë inspektuese të të gjithë Inspektorateve Shtetërore, në parametrat e zbatimit të ligjit, për të patur një proces inspektimi me standarde të drejta dhe të rregullta ligjore. Si rezultat i këtij standardizimi është ulur barra ndaj biznesit, është shmangur korrupsioni dhe klientelizmi i trupave inspektuese, një plagë e vjetër kjo, në veprimtarinë inspektuese në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin që lamë pas, kjo veprimtari përfshiu edhe Inspektoratet Vendore, konkretisht Bashkia e Tiranës, iu bashkua sistemit online të kryerjes së inspektimeve, pasi bashkëpunoi në mënyrë koherente për krijimin e dokumenteve standarde, listave të verifikimit si dhe trajnimit të inspektorëve me platformën e re të inspektimeve, në sistemin unik online “e-inspektimi”.

Inspektorati Qendror, si institucioni bërthamë me përgjegjësinë ligjore të përmirësimit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në vend, është imponuar dhe ka realizuar implementimin e inspektimeve në sistemin elektronik, e-inspektimi për të gjitha Inspektoratet Shtetërore, duke veçuar Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT).

Duke marrë shkas nga objektivat strategjike të ndërmarra më parë nga IQ, atë të ofrimit të ndryshimit rrënjësor në veprimtarinë inspektuese në vend, qasja jonë është avancimi më tej në këtë drejtim, duke propozuar ndryshimet në ligjin për inspektimin. Këto ndryshime janë pjesë e strategjive të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, që kanë si qëllim të nxisin, masat për të luftuar politizimin, korrupsionin, klientelizmin dhe ndërtimin e sistemit të rekrutimit dhe të karrierave të trupave inspektuese në përshtatje me praktikatat më të mira të inspektorateve, të vendeve të Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, koha ka treguar se, objektivat që ndërmerren nga të gjithë inspektoratet e të gjitha fushave të inspektimit nuk bëhen të realizueshme nëse në vend, nuk garantojnë inspektime sa më transparente dhe eficiente në të gjitha fushat e inspektimit, në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë, ne si Inspektorat Qendror, kemi propozuar modelin e riorganizimit të Inspektorateve Shtetërore, model i cili është përgëzuar dhe pritet të implementohet me përfshirjen dhe mbështetjen e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në mënyrë të ndershme dhe ligjore, por edhe nga qytetarët të cilët besojnë tek arritjet e standardeve evropiane në vendin tonë.

Por jo vetëm, ky model është pjesë e përfshirjes dhe e bashkëpunimit me asistencë dhe të aktorëve ndërkombëtarë si, Inspektorati i Përgjithshëm i Administratës Franceze, me të cilin është nënshkruar edhe Marrëveshje Bashkëpunimi strategjik, drejtues të lartë të Organizatës Për Zhvillim Ekonomik (OECD) si dhe me suportin nga ekspertë ndërkombëtarë në fushën e derregullimit të Projektit “Tweening Project Against Corruption”, i financuar nga BE.

Inspektorati Qendror, paraqiti në Dhjetor të vitit që lamë pas, arritjen e suksesshme në lidhje me modelin e kryerjes online të inspektimeve në sistemin unik “e-Inspektimi”, i implementuar në

veprimtarinë inspektuese në vend, në prezencë të përfaqësuesve të Qeverisë, aktorëve të interesit si dhe partnerëve tanë strategjik në fushën derregullatore të inspektimeve.

Në këtë prezantim, përfaqësuesit u njohën me materialin filmik të përgatitur nga Inspektorati Qendror, për konkretizimin e zbatimit të rregullores nr. 5, datë 10.08.2018 “Për kryerjen e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ”. Trupat inspektuese, të përbëra me tre deri në pesë inspektorë, tashmë i kryejnë procedurat inspektuese jo më me laptop dhe printer (si pajisje jo praktike për inspektorët, për kryerjen e procesit të inspektimit), por me **tableta**.

**Tableta**, e ka thjeshtuar së tepërmi procesin e inspektimit, për inspektorët dhe subjektet të cilët e mbyllin procedurën në vend nëpërmjet nënshkrimit elektronik, gjithashtu edhe për kryeinspektorët dhe specialistët e Inspektoratit Qendror, të cilët mbikëqyrin fotot, audiot dhe videot e administruara nga trupa inspektuese në vendin e inspektimit si dhe kanë informacion për pozicionin e trupave inspektuese, në kohë reale, nëpërmjet sistemit GPS. Fotot, audiot dhe filmimet administrohen në cilësinë e provës, duke shërbyer për rastet kur subjekti ankimohet tek Trupa Kolegjiale, pranë Inspektoratit Shtetëror, për fushën përkatëse apo/edhe në Gjykatën për Çështjet Administrative.

Modeli ynë i inspektimeve, u cilësua nga të pranishmit, si modeli i vetëm në Evropë. Përfaqësuesi i lartë i OECD, e konsideroi si një arritje të suksesshme për Inspektoratin Qendror si dhe një model, që do t’u prezantohet për zbatim edhe vendeve anëtare të OECD. Por gjithashtu shprehu se, Shqipërisë i duhet akoma të rregullojë në fushën e inspektimeve, sistemin e karrierës dhe atë të rekrutimit të inspektorëve, të cilat përmbushen me ndryshimet e ligjit, të propozuara nga ana jonë dhe që tashmë janë në diskutim.

Puna jonë për përmirësim të vazhdueshëm në këtë drejtim është, që nëpërmjet inspektimeve të arrijmë të formalizojmë bizneset dhe t’i krijojmë hapësirë konkurrencës së ndershme, e cila do të garantojë rritje ekonomike të qëndrueshme në vend, si pjesë e zbatimit të reformës ekonomike e shoqëruar edhe me riorganizimin cilësor të inspektorateve.

Duke qenë institucion kyç midis inspektorateve, ministrive përgjegjëse për të kontrolluar dhe mbikëqyrur veprimtaritë inspektuese, përmirësimet e vazhdueshme në veprimtaritë inspektuese online, do të garantojnë raportimin cilësor dhe transparent Këshillit të Ministrave, për situatën e inspektimit në vend dhe nga mbarëvajtja e këtyre marrëdhënieve, do të rrjedhin të gjitha efektet pozitive dhe ato negative për biznesin, konsumatorin dhe shoqërinë shqiptare.

Në emër të stafit, qytetarëve, bizneseve që na kanë besuar si dhe bashkëpunëtorëve ndërkombëtarë, Inspektorati Qendror do të udhëheq reformën e plotë të riorganizimit të trupave inspektuese të inspektorateve Shtetërore dhe Vendore në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare, të marra në Samitin e Londrës, në 2017.

## INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

### SHKËLQIM HAJDARI

# RAPORTI VJETOR I INSPEKTIMEVE 2018



*Adresa: Rruga Frosina Plaku, Godina e observatorit, Kati 0, Tiranë.  
Tel.: 042 229765, Fax.: 042 228983. [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al)*

**TABELA E PËRMBAJTJES**

|                                                                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Legjenda e Institucioneve .....                                                                                  | 6  |
| I. HYRJE .....                                                                                                   | 7  |
| II. QËLLIMI .....                                                                                                | 8  |
| III. METODOLOGJIA .....                                                                                          | 8  |
| IV. OBJEKTIVAT .....                                                                                             | 9  |
| V. Veprimtaria e Inspektoratit Qendror për Vitin 2018.....                                                       | 9  |
| VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS<br>MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT ..... | 11 |
| 1. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE .....                                                                     | 11 |
| 2. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME .....                                                                        | 12 |
| 2.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit .....                                                        | 12 |
| 3. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË.....                                                                      | 12 |
| 3.1 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore .....                                                | 12 |
| 4.1 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut .....                                                         | 13 |
| 3.1.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve.....                                                                 | 13 |
| 4.1.1 Ndjekja e ankimeve administrative të gjobave të vendosura nga strukturat e<br>ISHMT 14                     |    |
| 5.1.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm .....                                                    | 15 |
| 4. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË.....                                                                | 15 |
| 5.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial .....                                                           | 15 |
| 6.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit.....                                                           | 16 |
| 7.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion .....                                                     | 16 |
| 6.1 Autoritetit Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera.....                                            | 17 |
| 8.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike .....                                       | 17 |
| 7.1 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor .....                                                                     | 18 |
| 5. MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË.....                                                                   | 18 |
| 8.1 Inspektorati Shtetëror i Arsimit .....                                                                       | 18 |
| 6. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....                                                               | 20 |
| 9.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....                                                                          | 20 |
| 6.1.1 Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe OBU21                                   |    |
| 7.1.1 Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OSH dhe OBU.21                                   |    |
| 8.1.1 Sektori i mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore .....                                                 | 21 |
| 9.1.1 Sektori i koordinimit të inspektorëve në Pikat e Inspektimit Kufitar .....                                 | 22 |
| 10.1.1 Drejtoria e Shërbimeve Veterinare .....                                                                   | 22 |
| 10.1 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës .....                                                   | 23 |

|        |                                                                       |    |
|--------|-----------------------------------------------------------------------|----|
| 7.     | MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE .....                  | 23 |
| 11.1   | Inspektorati Shtetëror Shëndetësor .....                              | 23 |
| 12.1   | Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore .....            | 24 |
| 13.1   | Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet .....                                 | 24 |
| 8.     | MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT .....                               | 25 |
| 14.1   | Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit ..... | 25 |
| 11.1.1 | Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit.....                              | 25 |
| 12.1.1 | Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore.....                     | 26 |
| 13.1.1 | Drejtoria e Inspektoriatit të Ujërave .....                           | 27 |
| 14.1.1 | Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm .....               | 27 |
| VII.   | REZULTATET MBI VEPRIMTARITË INSPEKTUESE.....                          | 28 |
| VIII.  | INSPEKTIMET NË SISTEMIN “E-Inspektimi” .....                          | 41 |
| IX.    | NDRYSHIMET E PROPOZUARA TË LIGJIT PËR INSPEKTIMIN .....               | 43 |
| 1.     | Përkufizimi i Problemit.....                                          | 44 |
| 2.     | Objektivat.....                                                       | 44 |
| 3.     | Ndikimet .....                                                        | 45 |
| X.     | FAQJA ZYRTARE E INSPEKTORATIT QENDROR.....                            | 46 |
| XI.    | KOMENTE.....                                                          | 46 |
| XII.   | MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR .....                     | 48 |
| XIII.  | REKOMANDIME .....                                                     | 49 |
| XIV.   | KONKLUSIONE.....                                                      | 50 |

**Legjenda e Institucioneve**

|          |                                                                 |
|----------|-----------------------------------------------------------------|
| IQ       | Inspektorati Qendror                                            |
| IKMT     | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit                 |
| ISHPSHSH | Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore         |
| ISHTI    | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial                    |
| DING     | Drejtoria e Inspektimi të Naftës dhe Gazit                      |
| DIPNP    | Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion                |
| DIPIE    | Drejtoria e inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike  |
| ISHA     | Inspektorati Shtetëror i Arsimit                                |
| AKU      | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit                                  |
| OBU      | Operatorët e Biznesit Ushqimor                                  |
| DSHPA    | Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës             |
| AKSEM    | Autoritetit Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera    |
| DIH      | Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor                              |
| ISHMT    | Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut                  |
| DMP      | Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve                           |
| DMST     | Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm               |
| ISHMPUT  | Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit |
| DIM      | Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit                             |
| DIPP     | Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore                    |
| DIU      | Drejtoria e Inspektoratit të Ujërave                            |
| DIPP     | Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore                    |
| DIU      | Drejtoria e Inspektoratit të Ujërave                            |
| DMST     | Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm               |
| ISHSH    | Inspektorati Shtetëror Shëndetësorë                             |
| AKBPM    | Ajencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore             |
| ZMR      | Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet                                 |
| DPA      | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave                             |

## I. HYRJE

Përmbledhja e rezultateve të arritura në procesin inspektues në Republikën e Shqipërisë është mbështetur në Programin Qeverisë 2017-2021, në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 si dhe Planin Vjetor 2017.

Fokusi kryesor i Inspektoratit Qendror si institucion nukël, i cili monitoron, koordinon dhe drejton zbatueshmërinë ligjore në procesin e inspektimit në vend, vijon të jetë përmirësimi në cilësinë dhe performancën e veprimtarisë inspektuese të të gjitha fushave, për të cilat Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore nuk paraqiten ende në nivelin e duhur.

Inspektorati Qendror, bazuar tek Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Inspektoratet Shtetërore dhe ka evidentuar gjatë këtij viti se, është ekzistente nevoja për përmirësim e tyre dhe se ka mjaft problematika në lidhje me infrastrukturën, logjistikën, bazën ligjore si dhe me vetë ushtrimin e veprimtarisë inspektuese nga inspektorë të të gjitha fushave, në Operatorët e Biznesit.

Puna e deritanishme ka nxjerrë në pah arritjet e objektivave të IQ, siç është kryerja e të gjitha procedurave të inspektimit në sistemin unik, “e-inspektimi” me dokumente standarde, listë verifikimi dhe bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, për Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore.

IQ, ka bashkëpunuar gjatë kësaj kohe jo vetëm me ISH, por edhe me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, vendase dhe të huaja si dhe ka patur mbështetje nga ndërkombëtarë si, Inspektorati i Përgjithshëm i Administratës Franceze, me të cilin më datë 1 Shkurt 2018 është nënshkruar edhe Marrëveshje Bashkëpunimi, me drejtues të lartë të Organizatës Për Zhvillim Ekonomik (OECD) si dhe me suportin nga ekspertë ndërkombëtarë në fushën e derregullimit të Projektit “Tweening Project Against Corruption”, i financuar nga BE. Këto mbështetje kanë suportuar iniciativat e ndërmarra me qëllimin, e krijimit të procedurës së inspektimit në vend me standardet më të mira evropiane. Në këtë drejtim, Inspektorati Qendror ka hulumtuar në bashkëpunim për të studiuar praktikën e mira të inspektimeve të këtyre vendeve dhe ka punuar mjaft dokumente, dhe sugjeruar ndryshime në ligjin nr.10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo platformë e re, me ndryshimet e propozuar nga IQ si dhe me mbështetjen e të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit, ka për qëllim ndryshimin njëherë e mirë të situatës së inspektimeve në vend dhe paraqitet si modeli, i cili do të garantojë rritjen e transparencës, efikasitetit të trupave inspektuese, uljen e barrës administrative ndaj biznesit, si hap i rëndësishëm i goditjes së korrupsionit gjatë procesit të inspektimeve.

## II. QËLLIMI

Në përmbushje të detyrimit ligjor IQ, e përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve për njohje Këshillit të Ministrave.

Ky raportim kryhet nga të gjithë Inspektoratet Shtetërore, si detyrim ligjor bazuar në rregulla dhe standarde.

Në zbatim të detyrimit ligjor, nëpërmjet këtij raporti IQ, pasqyron me transparencë dhe objektivitet të gjitha gjetjet e konstatuara në Inspektoratet Shtetërore duke sugjeruar dhe rekomanduar për përmirësimin e aktiviteteve të tyre.

Inspektorati Qendror në veprimtarinë e vet, ka si qëllim:

- ✓ realizimin e inspektimeve të Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, të të gjitha fushave, në sistemin elektronik “e-Inspektimi”.
- ✓ realizimin e përlllogaritjes shkencore nga vetë sistemi “e-inspektimi”, të hartimit dhe përpunimit të programeve të inspektimit, bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut për të gjithë inspektoratet Shtetërore dhe Vendore.
- ✓ bashkëpunimin me Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e strategjive për zhvillim në fushën e veprimtarive inspektuese përkatëse.
- ✓ ushtrimin e detyrimit ligjor për bashkërendimin e programeve në fushën e inspektimeve.
- ✓ rritjen e performancës së inspektorëve nëpërmjet trajnimeve për inspektimin online.
- ✓ mbikëqyrjen e kryerjes të të gjitha veprimtarive inspektuese të Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore online, nëpërmjet tabletave me dokumente standarde, listë verifikimi dhe me metodologji të vlerësimit të riskut, për të rritur transparencën dhe efektivitetin.
- ✓ bashkërendimin dhe mbështetjen për hartimin e programeve të inspektimit.
- ✓ bashkëpunimin me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë vendase dhe të huaja/ Bizneset si dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi platformën e inspektimeve online.
- ✓ ofrimin e Shërbimit për shqyrtimin e ankimeve të subjekteve apo/edhe të qytetarëve, për veprimtaritë inspektuese të Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore.

## III. METODOLOGJIA

Për raportimin e veprimtarive inspektuese të Inspektorateve Shtetërore janë vlerësuar analizat vjetore të punës për Vitin 2018, për secilin prej tyre si dhe janë marrë parasysh evidencat e të dhënave në sistemin online të inspektime “e-inspektimi”.

Gjithashtu, performanca e inspektorateve shtetërore dhe ajo e punës së inspektorëve është vlerësuar për këtë vit edhe nëpërmjet kontrolleve të organizuara nga Task Forca, në mbështetje të vendimit nr. 241, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2015-2020.

Në vijim të këtij Raporti jepen dhe konkluzionet dhe rekomandimet për ushtrimin e kompetencave administrative për Inspektoratet si dhe nevojat që ato kanë për të rritur efektivitetin, duke marrë parasysh larminë e problematikave që kanë ndikuar dhe janë bërë evidente nga vetë ata.

#### IV. OBJEKTIVAT

Inspektorati Qendror, referuar tablosë të paraqitur nga analiza e punës së inspektorateve dhe problematikave të evidentuara, që lidhen me ushtrimin e kompetencave administrative si dhe kushteve infrastrukturore të tyre, për vitin 2019, synon të arrijë:

- ✓ të ndryshojë ligjin nr. 10433, datë 16.06.2019, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, sipas propozimit të ecurisë së inspektorit me sistem karriere, evitimin e të gjitha momenteve ligjore, të cilat bëhen burim abuzimi dhe keqinterpretimi nga inspektori.
- ✓ të riorganizojë inspektoratet me qëllimin e rritjes së efektivitetit të inspektimeve duke evituar inspektimet e mbivendosura, të rrisë transparencën, të ulë nivelin e korrupsionit si dhe të rrisë ekonominë e vendit duke stimuluar mbijetesën e bizneseve që ushtrojnë veprimtari konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ✓ të garantojë pavarësinë funksionale të Inspektorateve Shtetërore me efektin e ndarjes së politikë-bërjes nga procesi i inspektimit;
- ✓ të riorganizojë për të menaxhuar dhe koordinuar më mirë Inspektoratet Shtetërore;
- ✓ të përmirësojë më tej cilësinë e veprimtarisë inspektuese në lidhje edhe me një kod më të mirë veshjeje, sjelljeje e performance prej inspektorëve si dhe infrastrukture për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe kushtesh për marrjen dhe analizimin e mostrave të mara;
- ✓ të ushtrojë veprimtari inspektuese nga trupa inspektuese bazuar në parimet e përcaktuara në ligjin për inspektimin, për të garantuar procedura inspektimi të pavarura dhe transparente;
- ✓ të ulë numrin e inspektimeve të paprogramuara nga Inspektoratet Shtetërore të të gjitha fushave, me qëllim uljen e barrës administrative ndaj biznesit;
- ✓ të kryej realizimin e inspektimeve në sistemin unik “e-inspektimi” edhe për Inspektoratet Vendore në qarqe.
- ✓ të përfundojë në bashkëpunim me Inspektoratet Shtetërore që kryejnë veprimtari inspektuese në Pikat e Inspektimit Kufitar, hartimin e dokumenteve standarde për implementimin në sistemin unik të inspektimeve “e-inspektimi”.
- ✓ të evidentoj dhe përmirësoj problematikën në Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore dhe t’i adresoj ato.
- ✓ të rrisë përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, në zbatimin e detyrimeve ligjore, ndaj Inspektoratit Qendror.

#### V. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2018

Inspektorati Qendror, gjatë veprimtarisë së këtij viti, ka shënuar rezultate në zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e inspektimeve, standardizimin e procedurave inspektuese në Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore, duke trajnuar, bashkëpunuar dhe këshilluar me qëllim përmirësimin e cilësisë së inspektimeve në të gjithë inspektoratet si dhe ka evidentuar problematika.

Në këtë kuadër, Inspektorati Qendror ka synuar të arrijë objektivat e përcaktuara një vit më parë dhe gjatë kësaj kohe ka shënuar arritje në:

- ✓ Dixhitalizimin dhe standardizimin e të gjithë veprimtarisë inspektuese, kryerjen e tyre online, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”.
- ✓ Kryerjen e inspektimeve të programuara dhe bazuara në metodologjinë e vlerësimit të riskut, dokumentimin e veprimtarisë inspektuese konform ligjit për inspektimin, dhe ligjeve sektoriale.
- ✓ Pajisjen me tableta për kryerjen e veprimtarive inspektuese online, për të gjitha Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore.
- ✓ Integrimin e Inspektorateve Vendore në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi” dhe mbështetjen metodologjike për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë-verifikimeve dhe pajisjen e tyre me tableta për kryerjen inspektimeve online.
- ✓ Organizimin e trajnimeve të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë të të gjitha fushave të inspektimit, në lidhje me realizimin e inspektimeve, bazuar në rregulloren nr. 25, datë 10.8.2018, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ”, për përdorimin e programit të inspektimit online, me tableta si dhe me përditësimin e sistemit.
- ✓ Bashkërendimin dhe mbështetjen e veprimtarisë inspektuese të Inspektorateve Shtetërore si dhe rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë gjatë ushtrimit të detyrimeve ligjore nga trupat inspektuese, krahasuar me një vit më parë.
- ✓ Hartimin e rregullores nr. 25, datë 10.8.2018, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ”, me qëllimin e rritjes së cilësisë së inspektimeve.
- ✓ Paraqitjen e rregullores së procesit të inspektimit, gjatë trajnimeve të inspektorëve edhe në formatin filmik, për të qenë sa më e thjeshtë për zbatim gjatë procedurave të inspektimit, me qëllim rritjen e performancës në inspektime dhe bërjen e tyre sa më efektive dhe transparente.
- ✓ Krijimin e rregullores në formë broshure dhe shpërndarjen e saj, për inspektorët shtetërorë dhe vendorë si dhe për të gjithë grupet e interesit (biznes, ndërkombëtarë, etj.)
- ✓ Vënien në dispozicion të broshurave të rregullores së procesit të inspektimit, për inspektorët shtetëror dhe nënshkrimi i deklaratës për zbatimin e saj me përgjegjshmëri.
- ✓ Kryerjen e takimeve të njëpasnjëshme me të gjithë Dhomat e Biznesit vendase dhe të huaja me qëllim njohjen me, rregulloren nr. 25, datë 10.8.2018, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ”.
- ✓ Bashkëpunimin me Dhomat e Biznesit vendase dhe të huaja, në lidhje me hartimin e draft ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i propozuar për ndryshime.
- ✓ Zgjidhjen e problemeve, ankimeve të ndryshme të bizneseve dhe qytetarëve të adresuara në rubrikën e posaçme të Faqes Zyrtare të Inspektoratit Qendror, të cilat me inspektimet e kryera online, bëhen të mundura të ofrohen më shpejtë në kohë.
- ✓ Nëpërmjet faqes zyrtare IQ, përditëson me transparencë të plotë të gjithë informacionin për inspektimin, regjistrin e inspektorëve, ndryshimet ligjore, si dhe aktivitetet e organizuara.

Inspektorati Qendror, si anëtar i Task Forcës Antikorrupsion, në zbatim të VKM nr. 241, datë 20.04.2018, “Për miratimin e planit të veprimit 2018–2020, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015–2020, e të pasaportës së indikatorëve, krijimin,

funksionimin dhe detyrat e komitetit koordinator për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015–2020, dhe Task Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”, ka evidentuar shkelje të niveleve të ndryshme, deri tek ato më të rëndat, të shpërdorimit të detyrës, nga inspektorët e Inspektorateve Shtetërore, ku me të drejtën e ushtruar nga trupa e kontrollit ka marrë masa ndaj shkeljeve të konstatuara.

Shkeljet e konstatuara gjatë viteve të fundit, kanë qenë një pasqyrë e plotë e situatës në Inspektoratet Shtetërore dhe punës së kryer nga inspektorët, gjë e cila e ka përforcuar më tej nevojën për ndryshime në lidhje me riorganizimin strukturor dhe funksional të të gjithë trupave inspektuese, me qëllim krijimin e inspektorateve shtetërore me fusha të ngjashme inspektimi, të pavarura, bazuar në kriteret profesionale dhe sisteme karriere.

## VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT

### 1. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, ka për mision kontrollin e zbatimit të legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e saj inspektuese, është hartuar sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Rregullore e njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”. Drejtoria e Arkivave, në zbatim të VKM-së nr. 360, datë 26.04.2017, “Për organizimin dhe funksionim e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, ka filluar kryerjen e inspektimeve sipas ligjit për inspektimin. Gjatë këtij 2018, në bashkëpunim me IQ ka finalizuar dokumentet standarde dhe listë-verifikimet, të cilat tashmë janë të implementuar në sistemin “e-Inspektimi”.

Për vitin 2018, **ka planifikuar inspektime në 150 institucioneve** (subjekte), nga të cilat, 142 inspektime i ka realizuar në sekretari-arkivat të shtrira në mbarë vendin. Ka marrë masa administrative, dënim kryesor me “paralajmërim”. 8 institucione kanë kërkuar me shkresë zyrtare shtyrje inspektimi. 3 inspektime i ka kryer të paprogramuara. Për vitin 2018, ka kryer **145 inspektime online**.

**Problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve:** Mos ngritje e komisionit të ekspertizës pranë institucionit; Mos përpilim dhe miratim i listave konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve dhe të pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve; Mos respektim i elementëve të dokumentit në aktet zyrtare; Mos plotësim dhe përdorim sipas rregullave të mjeteve të evidencimit të dokumenteve si, regjistri i korrespondencës model 1, libri i dorëzimit (postës) model 4, libri i dorëzimit (shpërndarjes së dokumenteve) model 4/1 etj; Moskryerje e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve me RHK dhe mosdorëzim i tyre, në Arkivin Shtetëror përkatës; Moskryerje e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshëm dhe mos hartim i listave të veçimit për asgjësimin e tyre, sipas ligjit.

Për vitin 2019, në bazë të programit vjetor të inspektimit, është planifikuar kryerja e inspektimeve në 245 institucione (subjekte), ku të gjitha inspektimet do vazhdojnë të kryhen online, sipas ligjit për inspektimin.

## **2. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

### **2.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**

IKMT, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundra ligjshme”, i ndryshuar, siguron mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, zbatimin e dispozitave në menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe prodhimin e tregtimin e produkteve të ndërtimit.

IKMT-ja, gjatë vitit 2018, në bazë të kërkesave për mbështetjen e institucioneve qendrore /njësive vendore në lidhje me prishjen e objekteve /ndërtimeve kryesisht pengesë për realizimin e projekteve me interes publik, si dhe objekteve të kundërligjshëm të evidentuara, ka prishur gjithsej 768 objekte si edhe 50 objekte, të cilat janë shpronësuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në total janë prishur 818 objekte/ndërtime.

Gjatë vitit 2018, IKMT ka mbajtur gjithsej 239 vendime, nga këto 104 vendime për prishje objekti të kundraligjshme; 15 vendime për pezullim punimesh, si dhe 120 vendime me gjobë me vlerë absolute 84,590,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 1,340,000 lekë. Nga proceset gjyqësore të ngritura për vitin 2018, janë gjithsej 39 procese gjyqësore të rrëzuara (të fituara nga IKMT) pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nga të cilat 7 procese gjyqësore janë me objekt padie “dëmshpërblim”.

***Pra IKMT, për vitin 2018 ka realizuar 1 057 inspektime me blloqe.***

## **3. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

### **3.1 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, është institucioni i ngarkuar për kontrollin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore rregulluese që mbulojnë fushën e punës dhe në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

ISHPSHSH, gjatë 2018, ka ndërmarrë një sërë masash tejet transparente dhe inteligjente duke rikonceptuar Faqen Zyrtare, në një platformë informuese dhe ndërvepruese e aksesueshme nga të gjithë grupet e interesit në shqip dhe anglisht. Ka krijuar mundësi për aplikimin online të: Denoncimeve, Ankesave; Aplikimeve për kërkesë për Leje Pune, për Autorizim për kryerje të punës jashtë kohës normale, Autorizim për të punësuar të mitur; Ankim kundrejt vendimit të inspektimit si dhe informacione të tjera mbi inspektimet.

Ka integruar dhe bërë të aksesueshme Platformën “Matrica e Dënimeve”, me qëllimin e sigurimit të transparencës së vendimmarrjes së inspektorit të punës.

Ka bërë të mundur aksesin në kohë reale të Listë pagesave të punëmarrësve, të cilat deklarohen online nga subjektet në organet tatimore Formulari “E-sig 025” si dhe janë orientuar inspektorët e punës për Inspektimet Këshilluese, duke e konsideruar një etapë shumë të rëndësishme në marrëdhënien me biznesin. Me qëllim ngritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese, është

ngritur një ekip i brendshëm për trajnimet e inspektorëve, si në aspektet e komunikimit ashtu dhe të rritjes profesionale.

**Inspektimi në Punë:** Ka kryer, 12 514 Inspektime në sistemin unik “e-Inspektimi”, nga të cilat:

- 11 571 janë Inspektime të programuara;
- 943 të paprogramuara, nga të cilat 162 Inspektime për shkak aksidenti në punë; 467 Inspektime për shkak ankese; 314 Inspektime rastësore për shkelje flagrante.

**Ka evidentuar 1580 punëmarrës informal** ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 1515 prej tyre.

**Ka aplikuar masa për 1 538 inspektime:** nga të cilat 855 “Pezullime”, 1 538 “Paralajmërimë” dhe 183 masa me gjobë.

Janë ankimuar 48 vendime me gjobë ose 27% e gjobave të aplikuara, nga të cilat Komisioni i Ankimit të Vendime Përfundimtare ka lënë në fuqi 43 prej tyre apo 89%, dhe pjesa tjetër janë shfuqizuar. Nga sanksionet e vendosura në 183 subjekteve për këtë vit, janë arkëtuar vlera e 12 963 958 lekë.

**Inspektimi në Shërbimet Shoqërore:** Ka evidentuar të ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 296 subjekte publike dhe jopublike, (92 shërbime rezidenciale, 91 qendra ditore, 8 qendra multidisiplinare dhe 105 shërbime komunitare).

Ka inspektuar 129 qendra publike dhe jopublike, nga të cilat 116 të planifikuara dhe 13 të paplanifikuara.

#### 4.1 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

(ISHMT), e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në VKM nr. 36, datë 20.01.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, dhe është e organizuar në nivel qendror. ISHMT-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin e zbatimit e kërkesave ligjore për fushat: (1) mbrojtja e konsumatorëve; (2) mbrojtja e pronësisë industriale; (3) garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; (4) inspektimi metrologjik; (5) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji; (6) kontrolli i detergjenteve të vendosura në treg; (7) kontrolli i produkteve mekanike, ashensorë, pajisje të mbrojtjeve personale;

##### 3.1.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) përbëhet nga një staf prej 25 inspektorësh të ndarë në katër sektorë: Sektori i Produkteve Mekanike, Sektori i Produkteve Elektrike dhe Elektronike, Sektori i Inspektimit Metrologjik dhe Sektori Qelq/Këpucë/Detergjent/ Siguria e Produkteve.

Për vitin 2018, DMP **ka kryer gjithsej 1019 inspektime**, janë informuar rreth 355 subjekte dhe janë vendosur **141 masa administrative** nga të cilat 52 gjoba , 63 paralajmërimë dhe 26 masa urgjente me bllokim të mallit dhe shkatërrim të tij.

Numri inspektimeve mbi bazë ankese ka qenë 17. Janë kontrolluar 12817 produkte nga të cilat 1183 kanë qenë jo në konformitet.

***Inspektime për sigurinë e lodrave***, ka realizuar 44 inspektime të operatorëve ekonomikë të kategorizuar si importues kryesorë të produkteve lodra.

***Inspektime për sigurinë e detergjenteve***, ka kryer 87 inspektime të operatorëve ekonomikë të kategorizuar importues/prodhues. Janë kontrolluar 390 artikuj detergjente, nga të cilat 60 kanë rezultuar jo në konformitet. Ka vendosur 18 masa administrative nga të cilat 17 gjoba dhe 1 masë urgjente. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e përmbledhura për këto lloj inspektimesh.

Inspektimi për materialet kryesore që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, ka kryer 37 inspektime, ku janë kontrolluar 235 produkte nga të cilat 135 kanë qenë jo në konformitet dhe janë vendosur 16 masa administrative paralajmërim. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat e përmbledhura për këto lloj inspektimesh.

***Inspektimet e përbërjes së fibrave të produkteve tekstile***, ka kryer 65 inspektime, ku janë kontrolluar 448 produkte nga të cilat 169 kanë rezultuar jo në konformitet. Ka vendosur 25 masa administrative paralajmërim.

***Inspektime për para paketim***, ka kryer 663 inspektime të subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të para paketimeve.

Ka kontrolluar 2958 produkte nga të cilat kanë qenë jo në konformitet 395 produkte. Ka marrë në total 20 masa administrative nga të cilat 16 masa administrative me vendime gjobë dhe 4 masa administrative për ndalim të hedhjes në treg të produkteve.

***Inspektime për instrumentet matës ligjërisht të kontrollueshme***, ka kontrolluar 993 instrumente matës. Ka marrë në total 3 masa administrative nga të cilat 2 masa administrative me vendime gjobë dhe 1 masë administrative paralajmërim.

***Inspektime për produktet elektrike***, ka kryer 123 inspektime. Numri i produkteve të kontrolluara është 7475 nga të cilat 291 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur 34 masa administrative nga të cilat 7 janë gjoba, 22 paralajmërim dhe 5 masa urgjente.

***Inspektime për respektimin e të drejtave të autorit***, ka kryer 401 inspektime, nga të cilat 96 kanë qenë të nxitur nga ankesa. Ka informuar rreth 1218 subjekte. Ka vendosur 105 masa administrative nga të cilat 98 gjoba dhe 7 paralajmërim.

***Inspektime mbi pronësinë industriale***, ka realizuar 336 inspektime nga të cilat 11 janë kryer mbi bazë ankese. Janë informuar 333 subjekte dhe janë vendosur 74 masa administrative nga të cilat 69 paralajmërim dhe 5 gjoba.

#### ***4.1.1 Ndjekja e ankimeve administrative të gjobave të vendosura nga strukturat e ISHMT***

Gjatë vitit 2018, janë trajtuar në total **115 Ankime Administrative** nga të cilat 53 Ankime Administrative gjobë janë lënë në fuqi dhe 62 Ankime Administrative janë shfuqizuar nga Komisioni i Ankimit.

ISHMT, në total ka vendosur 183 gjoba, nga këto 115 janë ankimuar në rrugë administrative dhe 29 të ankimuara në rrugë gjyqësore.

Për 11 çështje, Gjykata Administrative ka dalë me vendim përfundimtar në favor të ISHMT-së dhe për 6 të tjerat janë pranuar kërkesëpaditë në favor të palëve paditëse. 12 gjoba janë në proces gjyqësor. 19 gjoba janë arkëtuar dhe 0 gjoba janë të pa ekzekutuara.

#### **5.1.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm**

DMST, ishte pjesë e strukturës së ISHMT, deri në fund të muajit Qershor 2018, sepse me VKM nr. 383, datë 27.6.2018, “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në Njësitë e Qeverisjes Qendrore për vitin 2018”, kjo drejtori kaloi si pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

DMST, për vitin 2018 ka kryer 258 inspektime, nga të cilat 225 inspektime të planifikuara dhe 17 inspektime të paplanifikuara dhe janë vendosur 12 masa administrative, të gjitha gjoba.

### **4. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

#### **5.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial**

ISHTI, realizon funksion inspektues në zbatim të VKM nr. 410, datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, nëpërmjet tre drejtorive: Drejtoria e Inspektimit të naftës dhe gazit; Drejtoria e Inspektimit të pajisjeve nën presion; Drejtoria e Inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike.

Aktiviteti inspektues i ISHTI-it kryhet sipas organizimit të miratuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 129, datë 6.11.2012. Organizimi përbëhet nga 32 inspektorë të organizuar në 6 sektorë për DING; 15 inspektorë të organizuar në 3 sektorë për DIPNP; dhe 15- inspektore të organizuar në 3 sektorë për DIPIE.

Këto sektorë për 2018, **kanë planifikuar 3 829 inspektime dhe kanë realizuar 4 656** nga këto **3 467 inspektime në sistemin online**, jashtë plani 1 189 inspektime. Inspektime me blloqe kanë qenë 302.

Masa administrative me gjobë janë vendosur 88, nga të cilat janë arkëtuar 14 me vlerë 49 540 000 lekë.

**Zyra juridike ka ndjekur 157 çështje**, nga të cilat janë rrëzuar 81 Kërkesë Padi të paraqitura pranë Gjykatave Administrative dhe ato të Rrethit; janë pranuar 48 Kërkesë Padi për të cilat është bere ankimi në Gjykatën Administrativ të Apelit Tirane, dhe Gjykatën e Apelit Tiranë; janë në proces ndjekje 28 dosje.

Gjatë vitit 2018, **laboratori i i kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre**, ka testuar gjithsej 7661 kampione nga të cilat 19 kampione kanë rezultuar me shmangie nga standardi **Laboratori i i kontrollit të lëkurë–tekstilit** ka analizuar 86 analiza.

### **6.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit**

Kjo drejtori, kryen veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit; kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj; kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës te konsumatorët e mëdhenj.

DING, ka planifikuar 805 inspektime për vitin 2018 dhe ka realizuar gjithsej 805 inspektime online sipas planit dhe 27 inspektime online jashtë planit. Objektet e inspektimit kanë qenë lidhur me:

- Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve të tyre,
- Inspektime për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat mbrojtëse kundra zjarrit,
- Inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse.

Në këto inspektime janë vendosur 49 masa administrative, nga të cilat 18 sanksione janë mbajtur për shmangie të cilësisë, 1 në subjekte sh.a. dhe 17 në subjekte sh.p.k.

Nga zyra juridike raportohen 35 gjoba të vëna dhe 5 të arkëtuara me vlerë 42 400 000.

**Objektivat për vitin 2019:** Realizimi i dixhitalizimit të stacioneve të karburanteve. Certifikimi i inspektorëve të DING/ISHTI, në lidhje me veprimtarinë inspektuese të tyre. Forcimi i bashkëpunimit me Pushtetin Vendor sipas ndarjes territoriale si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave e Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Nëpërmjet inspektimeve për kontrollet cilësore, në gjithë subjektet e tregtimit me shumicë e pakicë dhe konsumatorët, të arrihet që gjithë produktet që u ofrohen konsumatorëve, të jenë konform standardeve të miratuara.

### **7.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion**

Kjo drejtori e ushtron veprimtarinë inspektuese, në zbatim të ligjit nr. 32/2016, datë 24.03.2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve Nën Presion.

Gjatë vitit 2018 DIPNP, ka planifikuar për të kryer 1829 inspektime në operatorë ekonomik dhe ka realizuar 2062 inspektime, . Ka planifikuar 3938 inspektime në pajisje/instalime nën presion, në operatorët ekonomik dhe ka realizuar 4265 inspektime.

Inspektimet për evidentimin e operatorëve të rinj, janë kryer 2031 inspektime online dhe 302 me bllok. Janë urdhëruar 175, "Urdhër Ndalimi", për pajisje/instalime nën presion.

Janë vendosur 29 gjoba nga të cilat janë arkëtuar vetëm 5 me vlerë 4 600 000 lekë.

**Objektivat për vitin 2019:** Program Kontrolli për inspektimin e operatorëve ekonomikë në zonat turistike malore, për ri inspektimin e çerdheve dhe kopshteve, publike dhe jopublike, në Bashkinë Tiranë. Trajnimi periodik i inspektorëve për rritjen e aftësive teknike e profesionale gjatë inspektimeve online si dhe për njohjen dhe zbatimin e kuadrit teknik e ligjor të shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion etj.

## 6.1 Autoritetit Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera

AKSEM, është autoriteti përgjegjës për kontrollin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë në veprimtaritë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave energjetike.

Ky Inspektorat Shtetëror, ka funksion Inspektimin dhe realizimin e kontrolleve teknike në miniera nëntokësore e sipërfaqësore, fabrika pasurimi, impiantet e përpunimit të mineraleve dhe të punimeve nëntokësore të veprave hidroenergjetike për garantimin e sigurisë në punë në të gjitha subjektet e veprimtarisë minerare e inxhinierisë civile në Republikën e Shqipërisë. Gatishmërinë dhe sigurinë për ndërhyrje në emergjencë, avari e operacione shpëtimi në miniera, punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike si dhe në kuadrin e emergjencave civile.

Gjatë vitit 2018, AKSEM ka realizuar inspektime në:

- ✓ Minierat me regjim ose shfaqje gazi janë inspektuar 3 herë në vit.
- ✓ Minierat nëntokësore pa regjim gazi 2 herë në vit.
- ✓ Punime nëntokësore të veprave hidroenergjetike 2 herë në vit.
- ✓ Minierat sipërfaqësore 1 herë në vit.

AKSEM, ka **programuar 869 inspektime dhe ka realizuar 630 inspektime**. Nga këto 611 inspektime të programuara dhe 19 jashtë programit si dhe 616 Inspektime janë me njoftim paraprak dhe 14 pa njoftim paraprak.

Ka marrë **11 Vendime të Ndërmjetme; 11 paralajmërime dhe 11 gjoba** me vlerë totale 1,570,000 lekë ndaj 6 subjekteve.

Pranë Komisionit të animimit të gjobave janë ankimuar 4 masa administrative gjobë, nga të cilat vetëm 1 gjobë me vlerë 150 000 është shfuqizuar.

2 gjoba janë ekzekutuar vullnetarisht me shumën 250 000 lekë, 3 gjoba janë ekzekutuar nga Zyra Përmbartimore Dibër, me vlerë 310 000 lekë, në total 560 000 lekë.

Nga informacioni i gjeneruar pranë portalit gjatë vitit 2018, AKSEM ka realizuar në **total 511** inspektime, nga të cilat 3 janë jashtë programi dhe 508 të programuara.

Nëpërmjet portalit janë marrë vetëm 2 masa administrative me vlerë totale 450 000 lekë.

### 8.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike

Kjo drejtori inspekton sigurinë elektrike të pajisjeve dhe instalimeve elektrike në zbatim të ligjit nr.8734, datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike”, dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Gjatë këtij viti, kanë ndodhur gjithsej 21 aksidente, nga këto 17 aksidente me vdekje dhe 4 aksidente me plagosje. Gjatë vitit 2017 kanë ndodhur gjithsej 12 aksidente, nga këto 9 aksidente me vdekje dhe 3 aksidente me plagosje. Shkaqet e këtyre aksidenteve kanë të bëjnë me: mos zbatimin e procedurave të punimit; ndërhyrje të paligjshme në ambiente elektrike për qëllime të ndryshme; ndërhyrje në rrjetin elektrik e personave të pa autorizuar dhe që nuk janë specialistë për të kryer punë elektrike. Për këto raste janë marrë propozuar 16 masa administrative me gjobë, me vlerë 3.020.000 lekë.

Për vitin 2018 DIPIE, ka planifikuar 1195 inspektime dhe ka realizuar 1172 inspektime online, nga këto 933 janë të programuara dhe 239 janë jashtë planit.. Gjatë vitit 2018 DIPIE, ka realizuar online 8 inspektime të shoqëruara me masë administrative gjobë, me vlerë 1.120.000 lekë.

Në total janë vendosur 24 gjoba nga të cilat janë arkëtuar 4, me vlerë 2 540 000 lekë.

**Objektivat për vitin 2019:** krijimi i bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike; zbutja e riskut elektrik në përputhje me parimin e proporcionalitetit gjatë veprimtarisë inspektuese; përmirësimi i formateve të inspektimit; trajnimi i inspektoreve lidhur me njohjen dhe zbatimin e rregullave e normave teknike në fuqi si dhe nevoja e përafrimit të tyre me normat dhe rregullat bashkëkohore evropiane.

## 7.1 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor

Inspektorati Shtetëror i DIH, funksionon në bazë të nenit 78, të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, urdhër nr. 154, datë 27.10.2010, rregullorja, “Shfrytëzimi Teknik i Hekurudhave”, rregullorja nr. 14 “Për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore”, rregullorja nr. 11, “Për dhënien dhe heqjen e Dëshmimeve të Aftësisë”, rregullorja nr. 3602, datë 18.8.2011, “Mbi mënyrën e ngarkimit të mallrave në vagonët hekurudhorë”, rregullorja “Mbi detyrat dhe të drejtat e punonjësve të hekurudhës në lëvizjen e trenave”.

Për vitin 2018 DIH ka planifikuar 80 inspektime dhe ka kryer 80 *inspektime në sistemin online*. DIH ka kryer edhe 408 monitorime, me një ritëm 38 kontrolle në muaj për inspektor, nga 60 kontrolle që janë realizuar mesatarisht gjatë vitit 2017.

Masa administrative me gjobë, me vlerë 9000 lekë dhe janë arkëtuar 9 000 lekë.

Kanë ndodhur 22 aksidente, ku 3 raste janë aksidente me vdekje.

## 5. MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

### 8.1 Inspektorati Shtetëror i Arsimit

ISHA, në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është struktura përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar.

Përgjegjësitë specifike të ISHA-s, realizohen nëpërmjet kryerjes së: Funkzioni vlerësues; Funkzioni kontrollues; Funkzioni këshillues; Funkzioni informues dhe raportues.

ISHA, ka kontrolluar pajtueshmërinë e veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ka monitoruar, vlerësuar dhe ka nxjerrë përfundime duke dhënë këshillime për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

Për vitin 2018, ISHA ka planifikuar 172 inspektime, dhe ka kryer;

- 173 inspektime dhe 350 monitorime;
- 129 inspektime janë të programuara;
- 44 inspektime janë kryer jashtë programit.

***Nga 129 inspektimet programuara***, 13 prej tyre janë inspektime të plota me qëllim vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucioni arsimor dhe 69 janë inspektime tematike për vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar:

- në vlerësimin e arritjeve të nxënësve për kurrikulën me kompetenca;
- në hartimin e planeve vjetore lëndore;
- në hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të shkollës;
- në hartimin dhe zbatimin e rregullores së brendshme të shkollës;
- vlerësimin e njësive arsimore vendore dhe institucioneve arsimore parauniversitare për cilësinë e ofruar;
- në plotësimin e kartës së performancës së shkollës;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në zhvillimin e praktikave profesionale.

***Nga 44 inspektimet e orientuara jashtë programit, 30 inspektime janë iniciuar pa autorizimin e Kryeinspektorit por me urdhër të Ministrit të Arsimit.*** Nga këto, 5 janë kryer për vlerësimin e zbatimit të kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore private, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; 39 për shqyrtimin e rasteve të ankimeve.

***350 monitorimet janë kryer lidhur me:*** Praktikat profesionale; Klasat kolektive; Portalin “Mësues për Shqipërinë”; Olimpiadat; Testimin e klasave V; Përgatitjen për zhvillimin e Maturës Shtetërore; Procesin e vlerësimit gjuhësor të teksteve shkollore; Maturën Shtetërore 2018; Provimet e Lirimit 2018; Përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore; Mospërdorimin e celularit gjatë procesit mësimor; Cilësinë e ofruar nga agjencitë trajnuese në trajnimet e mësuesve.

***ISHA, ka shqyrtuar 39 ankimime për verifikimin e problemeve të ngritura lidhur me:*** menaxhimin e burimeve njerëzore; plotësimin e dokumentacionit shkollor; komunikimin mësues-nxënës dhe drejtues-mësues; vlerësimin e shërbimit arsimor të shkollës; respektimin e Kodit të Etikës nga mësuesit; bashkëpunimin e drejtorisë së shkollës me mësuesit, organizmat e shkollës, prindërit.

ISHA, i ka propozuar Ministrit të MASR, ***7 masa administrative*** si dhe mbylljen e veprimtarisë mësimore për 2 kopshte jopublike, dhe 1 shkollë të mesme jopublike.

***Objektivat e ISHA-së për vitin 2018***, janë për realizimin e inspektimeve online, bazuar në metodologjisë e vlerësimit të riskut si për inspektimet e plota, me tematikë dhe ato të orientuara. ISHA, do të zgjidhë ankimimet në fushën e arsimit parauniversitar që vijnë nga nxënës, mësues, prindër dhe qytetarë; do të verifikojë rastet e denoncimeve të ardhura nëpërmjet MASR-it ose institucioneve të tjera. Monitorimi do të jetë për përzgjedhjen dhe

shpërndarjen e teksteve shkollore; zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të pesta; zhvillimin e Provimeve të Lirimit; zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore; zhvillimin e olimpiadave kombëtare; zhvillimin e testimit të mësuesve për portalin “Mësues për Shqipërinë”; zhvillimin e provimit të kualifikimit të mësuesve; procesin e hartimit të Kartës së Performancës, etj.

## **6. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural ka në juridiksionin e saj dy Inspektorate Shtetërore.

### **9.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit garanton sigurinë e konsumatorit duke ushtruar kontrole në të gjithë OBU, kryen kërkime dhe analizon informacione teknike dhe shkencore, monitoron në mënyrë të vazhdueshme riskun i cili mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi sigurinë e ushqimore në zbatim të ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” e ndryshuar.

Sektorët e inspektimit janë pjesë përbërëse e ***Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit*** dhe luajnë rol shumë të rëndësishëm në sigurinë ushqimore si dhe në tërë zinxhirin ushqimor.

Sipas Programit Vjetor të 2018, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për të tre sektorët, ***ka planifikuar të kryejë 30 367 inspektime dhe ka realizuar 28 504 inspektime***. Nga këto:

Të programuara 20 388 inspektime;

Të pa programuara 8 116 inspektime;

Të kryera online 14 607 inspektime;

Të planifikuara dhe kryera online 11 257 inspektime;

Të paplanifikuara dhe kryera online 3 350 inspektime.

#### ***Totali i Masave Administrative:***

Masa administrative 1 599 me vlerë 294 686 lekë;

#### ***Gjoha të Ankimuar në AKU:***

Gjoha të Ankimuar në AKU 727 me vlerë 163 330 lekë;

#### ***Ankimime të Trajtuara nga Komisioni i Ankimit pranë AKU:***

Ankimime të trajtuara 501 me vlerë 104 630 lekë;

Ankimime të rrëzuara 498 me vlerë 104 330 lekë;

Ankimime të pranuar 3 me vlerë 300 lekë;

#### ***Procese Gjyqësore me Objekt Shfuqizim:***

Totali i Padive 183 me vlerë 64 420 lekë;

Rrëzim Padie 129 me vlerë 47 420 lekë;

Pranim Padie 38 me vlerë 10 106 lekë;

#### ***Ekzekutimi i Masave Administrative:***

Vullnetarisht me vlerë 24 335 lekë;

Me A-M me vlerë 10 667 lekë.

Gjatë vitit 2018, të tre sektorët kanë përgatitur, vlerësuar dhe përcjellë **397 kërkesa për licencim të miratuara**.

#### **6.1.1      *Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe OBU***

Veprimtaria e këtij sektori konsiston në koordinimin e gjithë procesit të inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë joshatazore dhe operatorëve të biznesit. Kontrollat zyrtare bazohen në përpunimin e informacioneve mbi aktivitetin e kryer nga Drejtoritë Rajonale të AKU.

Ky sektor për vitin 2018 ka planifikuar të realizojë 13 051 inspektime;  
 Ka realizuar 12 655 inspektime;  
 Ka kryer Pa-Planifikuar 3 832 inspektime;  
 Ka vendosur masë administrative kryesore me paralajmërim në 4 540 subjekte;  
 Gjaba në 610 subjekte, me vlerë 127 555 lekë;  
 Ka bllokuar sasi produktesh: 3 883,79 ton, 92 376,15 litra;  
 Ka asgjësuar: 2926,03 ton; 6 925,5 litra;  
 Ka ndërprerë plotësisht 141 aktivitete biznesi dhe pjesërisht 4 aktivitete biznesi;  
 Ka kryer 1 625 mostra për analizë nga të cilat 1 591 kanë rezultuar konforme dhe 34 jo konforme.

#### **7.1.1      *Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OSH dhe OBU***

Ky sektor garanton sigurinë ushqimore gjatë gjithë zinxhirit, duke koordinuar të gjithë procesin e inspektimit të operatorëve të biznesit që prodhojnë, përpunojnë, ambalazhojnë, etiketojnë, magazinojnë shpërndajnë dhe tregtojnë produkte me origjinë shtazore, stabilimentet e përpunimit të peshkut dhe eksportin e tyre në BE si dhe licencimin e stabilimenteve të përpunimit të produkteve me origjinë shtazore.

Ky sektor për vitin 2018 ka planifikuar të realizojë 12 710 inspektime;  
 Ka realizuar 11 170 inspektime;  
 Ka kryer Pa-Planifikuar 3 647 inspektime;  
 Ka vendosur masë administrative kryesore me paralajmërim në 3 061 subjekte;  
 Gjaba në 895 subjekte, me vlerë 157 680 lekë;  
 Ka bllokuar sasi produktesh: 8011 ton, 11 487,5 litra, 21 680 kokrra vezë;  
 Ka asgjësuar: 2 376,7 ton; 4 357,5 litra; 20 530 kokrra vezë;  
 Ka ndërprerë plotësisht 214 aktivitete biznesi;  
 Ka kryer 2 062 mostra për analizë nga të cilat 1996 kanë rezultuar konforme dhe 66 jo konforme.

#### **8.1.1      *Sektori i mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore***

Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore ka për qëllim planifikimin dhe koordinimin në kohë dhe me efikasitet, zbatimin dhe raportimin mbi planet e kontrolleve

zyrtare të kryera në të gjithë vendin me synim menaxhimin e riskut në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore. Ky sektor operon në fushën e Mbrojtjes së Bimëve, në fushën e Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor, në fushën e tregtimit të Plehrave të Përdorimit për Bimësinë dhe në fushën “E prodhimit dhe tregtimit të duhanit dhe të cigareve”.

Ky sektor për vitin 2018 ka planifikuar të realizojë 4 606 inspektime;

Ka realizuar 4 679 inspektime;

Ka kryer Pa-Planifikuar 637 inspektime;

Ka vendosur masë administrative kryesore me paralajmërim në 99 subjekte;

Gjoha në 94 subjekte, me vlerë 157 680 lekë;

Ka bllokuar sasi produktesh: 389,2 ton; 294 litra;

Ka asgjësuar: 43 ton;

Ka ndërprerë plotësisht 2 aktivitete biznesi;

Ka kryer 390 mostra për analizë nga të cilat 356 kanë rezultuar konforme dhe 19 jo konforme.

### **9.1.1      *Sektori i koordinimit të inspektorëve në Pikat e Inspektimit Kufitar***

Sektori i Koordinimit të Inspektorëve në PIK-e kryen koordinimin në kohë dhe me efikasitet, dhe raportimin e kontrolleve zyrtare të kryera në 13 Pikat e Inspektimit Kufitar, me synimin garantimin e sigurisë ushqimore të ushqimeve, ushqimeve për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, mbrojtjes së bimëve, produkteve bimore dhe inputeve bujqësore.

Ky sektor për vitin 2018 ka realizuar 66 640 inspektime;

Produkte me origjinë Jo Shtazore 31 891 inspektime;

Produkte me origjinë Shtazore 10 194 inspektime;

Produkte / Material Veterinar 223 inspektime;

Bime dhe Produkte Bimore 20 942 inspektime;

Material Mbjellës dhe Shumëzues Bimor 258 inspektime;

Plehra për Përdorim për Bimësi 818 inspektime;

Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) 470 inspektime.

### **10.1.1      *Drejtorja e Shërbimeve Veterinare***

Është sektori pranë MBZHR, përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, që ushtron veprimtari në zbatim të ligjit nr. 10465/2011 “Për Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9863/2008, “Për ushqimin” si edhe akte të tjera ligjore, në funksion të shërbimit veterinar.

Ky sektor, nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të raportimit për punën e realizuar për vitin 2018 edhe pse ka qenë koherent në të gjitha aktivitetet dhe trajnimet e organizuara nga IQ.

Gjatë vitit 2019, janë trajnuar disa herë, 61 inspektorë për përdorimin e sistemit online të inspektimit.

## 10.1 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës

DSHPA, është struktura përgjegjëse në mbrojtjen e peshkimit dhe Akuakultuës, që ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, I ndryshuar”, VKM nr. 44, datë 29.01.2014, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës”, I ndryshuar”.

DSHPA në vitin 2018, i ka kryer të gjitha procedurat inspektuese në sistemin elektronik online, e-inspektimi.

Spektori i Monitorimit Inspektimit ka kryer kontrole dhe inspektime të vazhdueshme në subjektet që zhvillojnë aktivitet peshkimi në këto drejtime kryesore:

- Inspektim në vijën bregdetare
- Inspektim në det
- Inspektim për evidentimin dhe parandalimin në ujëra të brendshëm
- Inspektim në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve peshkore
- Inspektim për evidentimin dhe parandalimin të lëndëve plasëse

Gjatë vitit 2018, Spektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e Peshkimit ka kryer ***gjithsej 1452 Inspektime***, ka vendosur ***66 masa-Administrative*** dhe ***84 propozime për heqje licence***.

Inspektorati i Peshkimit, i ka propozuar Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Ankimimeve heqjen e licencës ndaj 38 subjekteve që nuk kanë kryer pagesën e taksës vjetore kombëtare për vitin 2018.

Janë bllokuar mjete peshkimit artizanal të paligjshëm dhe të pa licencuar.

Nëpërmjet njësisë Task – Forcë, është parandaluar gjuetia e paligjshme dhe janë grumbulluar 150 kg vezë peshku, dhe janë marrë masa administrative me gjobë, sekuestrim i pajisjeve dhe veglave të peshkimit të paligjshme. Në bashkëpunim me policinë Bashkiake Sarandë janë prishur 22 objekte në zonën breg liqenore dhe janë propozuar për heqje licence 20 subjekteve, Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Ankimimeve. Në liqenin e Prespës janë marrë masa me pezullim aktiviteti për 13 subjekteve.

Në pikat e tregtimit janë marrë dy masa administrative. Janë adresuar dy raste për ndjekje Prokurorisë, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

## 7. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

### 11.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike. ISHSH në përmbushje të detyrimeve ligjore, synon:

- të rrisë sigurinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë;
- të krijojë një sistem të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave brenda fushës që mbulon;

- të ndërgjegjësojë subjektet e inspektimit për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë shëndetësore;
- të mbrojnë konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e shëndetësisë;
- të ndërgjegjësojë operatorët e biznesit shqiptarë dhe konsumatorëve lidhur me praktikën e mira të higjienës shëndetësore që duhet të aplikohen në të gjithë fushën e aktivitetit të ISHSH.

Gjatë vitit 2018, nga ISHSH janë raportuar 25 705 inspektime, nga të cilat 2 436 janë ri-inspektime, por nga portali unik i inspektimeve “e-inspektimi” rezultojnë 26 130 inspektime të mbyllura nga të cilat 19 338 janë të programuara dhe 6 792 jashtë programi. 3584 subjekte janë pajisur me Akt Miratim higjieno sanitar. Janë raportuar 305 masa administrative gjobë, nga të cilat 193 masa administrative janë në zbatim të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit si dhe janë marrë 77 vendime (të ndërmjetme, për pezullim të pjesshëm/të plotë) dhe 145 paralajmërime. 67 nga masat administrative të marra nuk janë realizuar online, por nëpërmjet blloqeve (në muajt Janar-Shkurt 2018). Nga mbikëqyrja në portal rezultojnë 239 masa administrative gjobë.

Gjatë vitit 2018, pranë ISHSH qendror, Komisioni i Ankimimit Administrative të Trupës Kolegjiale ka shqyrtuar 200 masa administrative nga të cilat 182 masa janë lënë në fuqi dhe 18 janë anuluar.

Gjatë vitit 2018, janë ekzekutuar 87 masa administrative me shumë totale 21,872,930.23 lekë. Janë ndjekur 84 procese gjyqësore, nga të cilat 23 procese gjyqësore janë fituar dhe 21 janë humbur, ndërsa pjesa tjetër është në proces.

### 12.1 Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

AKBPM, vepron në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”. Veprimtaria inspektuese dhe kontrolluese e rrjetit farmaceutik konsiston në: mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve farmaceutike (depo, farmaci, agjenci farmaceutike) në drejtim të respektimit të kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave, të kushteve të ruajtjes së shpërndarjes së mirë të barnave, monitorimin e publicitetit për barnat, dhe inspektimin e pajisjeve mjekësore.

Gjatë vitit 2018, ka inspektuar dhe **kontrolluar 603 subjekte** inspektimi nga të cilat: 592 subjekte farmaceutike dhe agjenci farmaceutike; 11 raste depo importuese dhe/ose shpërndarës farmaceutikë; 14 Inspektime për barna të skaduara, bazuar në kërkesë e subjekteve farmaceutike; 1 Inspektim në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit (Sektori kundër krimit Ekonomik dhe financiar). Ka vendosur **182 masa administrative**.

### 13.1 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, si organ ekzekutiv, ka si mision të përcaktojë kushtet e mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë

radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht, të popullatës dhe mjedisit në tërësi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar në maksimum të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese.

Inspektimet e programuara të realizuara gjatë vitit 2018, *janë realizuar online* në kuadër të implementimit të sistemit unik “e-Inspektimi”. Numri i inspektimeve të realizuara në total është **46 subjekte**, konkretisht janë për 14 subjekte shtetërore dhe 32 subjekte privat, që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Gjatë procesit të inspektimit janë marrë gjithsej **9 masa administrative** kryesore: 2- heqje licence dhe 7 paralajmërime. Është ankimuar një nga këto masa administrative “Heqje licence”, sepse nuk janë deklaruar ndryshimet pranë ZMR-se. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pas shqyrtimit të rastit, ka lënë në fuqi vendimin e inspektorëve të ZMR-së.

Janë kryer dhe dokumentuar 51 matje të fuqisë së dozës së rrezatimit në vendqëndrimet e personelit të angazhuar në punë me pajisjet rrezatuese si dhe për publikun. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se, në asnjë rast nuk kalohen limitet e përcaktuara në rregulloren Nr.543 datë 7.07.2010 “Për punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues”.

## **8. MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

### **14.1 Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit**

ISHMPUT, ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit dhe ushtron funksionet e veta në zbatim të VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve”, i ndryshuar.

Aktiviteti inspektues realizohet nga katër drejtori, Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore, Drejtoria e Ujërave dhe Turizmit, me qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, pyjeve, shëndetit të njerëzve dhe cilësisë së jetës.

#### **11.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit**

Gjatë vitit 2018, DIM ka pasur në fokus inspektimin e subjekteve për menaxhimin e mbetjeve urbane; inspektimin e subjekteve për menaxhimin mbetjeve spitalore; inspektimin e subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore lidhur me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore; identifikimin e subjekteve pa leje mjedisore dhe kontrollin e tyre; si dhe bashkëpunimi me DRM-të dhe AKM për pajisjen e këtyre subjekteve me lejen përkatëse mjedisore të tipi A, B, C, si dhe verifikimi i 28 ankesave të bëra në portalin e bashkëqeverisjes: “Për Shqipërinë që duam”, në portalin “Anti-korrupsion” dhe “Mjedisi im”.

Në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror dhe me projektin IBECA, janë kryer trajnime për inspektimet online.

Gjatë vitit 2018, në fushën e mjedisit ka **programuar 4000** inspektime ka **realizuar 2612 inspektime**, nga këto 2260 inspektime të programuara dhe 352 inspektime jashtë programit.

Ka vendosur **253 masa administrative** me gjobë, me vlerë 134 730 000 lekë, 31 dënime me paralajmërim dhe 124 pezullime dhe mbyllje aktiviteti.

### **12.1.1 Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore**

DIPP, ka ushtruar inspektime në veprimtarinë ekonomike në fondin pyjor kullosor, në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, në strukturat përgjegjëse të pyjeve në bashki në drejtim të fushave që mbulon në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe “Manuali i Përgjithshëm i Inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Ka ngritur grupe pune për evidentimin e problematikave në pyje, në zbatim të urdhrit nr. 16, datë 06.11.2017, “Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë”, ku janë evidentuar: subjektet që shfrytëzojnë pyjet, kullotat dhe bimët; ndërhyrjet dhe aktivitetet në Zonat e Mbrojtura; subjektet e përpunimit dhe manipulimit të lëndës drusore dhe druve të zjarrit, si dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme, kafshëve në aktivitet dhe i prerjeve të paligjshme.

Për vitin 2018, **ka planifikuar 8 000 inspektime dhe janë realizuar 3222 inspektime.**

**Masat administrative për prerje të paligjshme** me gjobë **291**, me vlerë të gjobave 136.870.000 lekë dhe dëmi 2.207.768.000 lekë;

**Masa për Kundërvajtjet në fushën e gjuetisë** me Proces Verbal, **22** me vlerë 1.516.000 lekë;

**Masat Penale në fondin pyjor e kullosor**, **41** me vlerë dëmit 3.595.878.000 lekë.

**Sekuestrimet:** 238 raste me lëndë drusore, me volum 4124 m<sup>3</sup>, nga këto 420 m<sup>3</sup> është lëndë punimi dhe 3704 m<sup>3</sup> dru zjarri.

**Drurë të prerë nga “Prerjet e paligjshme”,** gjithsej 15032 copë, me volum 4616 m<sup>3</sup>, nga të cilat 11124 copë drurë janë pa autor, dhe 3908 copë drurë me autor.

DIPP-Qendër ka realizuar **89** inspektime dhe vendosur **25** masat administrative nga të cilat **20** për “Transport të paligjshëm të materialit drusorë”, me vlerë gjobe **1.920.000 lekë**; **2** për shpalljen e moratoriumit në pyje, me vlerë gjobe **10.000.000 lekë** dhe **3**, për gjueti të paligjshme, me vlerë gjobe **110.000 lekë**.

DIPP për shpalljen e moratoriumit në pyje, ka vendosur **24** gjoba me vlerë **120.000.000 lekë**.

Gjatë këtij viti janë konstatuar gjithsej **65 raste zjarresh, me sipërfaqe totale prej 2283 ha.**

Për gjueti të kundërligjshme, në shkallë vendi, për periudhën janar-dhjetor 2018 janë mbajtur **21 proces-verbale** dhe janë vendosur 1.430.000 lekë gjoba.

Gjatë vitit 2018, janë sekuestruar në lokalin “SAFARI ZOO”, Fier 11 kafshë të egra, të cilat u transportuan në qendra të specializuara të rehabilitimi.

### 13.1.1 Drejtoria e Inspektoratit të Ujërave

Kjo drejtori filloi aktivitetin pranë ISHPMUT, më datë 21 shtator 2018 (referuar shkresës së ardhur nga Departamenti i Administratës Publike për transferimin e inspektorëve të ISHU-së, për shkak të ristrukturimit).

Për periudhën e mbetur të vitit 2018 DIU, u angazhuar për arritjen e objektivave:

- ✓ Përmirësimi në vazhdimësi i listë-verifikimeve në portalin e-inspektimi dhe përdorimi me sukses i këtij portali për kryerjen 100% të inspektimeve online të planifikuara, mbështetur në planin e punës të miratuar të vitit 2019, për zbatim të kërkesave ligjore në fushën e inspektimit të ujërave.
- ✓ Zbatimi i ligjshmërisë, rritja e efektivitetit të inspektimeve, mbrojtja e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike.
- ✓ Sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe zhvillimin social ekonomik të vendit.
- ✓ Hartimi i regjistrit të bazës së të dhënave për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në bazë të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" në fushën e ujërave.
- ✓ Evidentimi i subjekteve që e përdorin ujin për qëllime biznesi dhe pajisja e tyre me leje.

### 14.1.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm

Ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të turizmit nga subjektet mbi të cilat vepron nenin 16/2 i ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit.

Bazuar në planin sektorial mujor të inspektimeve përgjatë vitit 2018, janë **planifikuar 356 inspektime** nga këto 339 të programuara dhe 17, të programuara për t'u kryer jashtë plani. DMST ka kryer **43 inspektime në Operatorë Turistikë dhe 313 inspektime në Agjenci Udhëtimi**.

Ka vendosur **36 masa administrative** me "gjobë" nga të cilat 17 janë ankimuar pranë komisionit të shqyrtimit të ankimimit administrativ në ISHMT nga të cilat 16 janë rrëzuar.

3 (tre) subjekte nuk kanë kryer ankimim të vendimit të inspektimit, prej të cilave 2 (dy) janë pjesë e procesit të përmbarimit, dhe 1 (një) është në procedurë për t'i kaluar shërbimit përmbarimor.

**Objektivat e DMST për 2019:** kryerja e inspektimeve për kontrollin e kriterëve ligjore nga subjektet në lidhje me fushat që janë në fokusin e punës së DMST-së; evidentimi i strukturave akomoduese në të gjithë vendin me qëllim ngritjen e data bazës së të dhënave për to, e cila i shërben procesit të inspektimit të tyre, si dhe procesit të klasifikimit të SA nga strukturat përgjegjëse (proces që ende nuk ka filluar); hartimi i metodologjisë së riskut për subjekte që veprojnë në fushën e agjencive dhe operatorëve turistikë, duke u nisur nga rezultatet e inspektimeve të vitit 2018.

## VII. REZULTATET MBI VEPRIMTARITË INSPEKTUESE

Nga raportimet e Inspektorateve Shtetërore si dhe gjatë prezantimeve të organizuara me ISH, IQ ka konstatuar arritjet dhe problematikat e tyre gjatë ushtrimit të detyrave funksionale institucionale. Ndërkohë një etalon i punës në Inspektoratet Shtetërore janë dhe rezultatet e kontrolleve të Task Forcës Antikorrupsion për kryerjen e misionit funksional, ligjor gjatë veprimtarive inspektuese të Inspektorateve Shtetërore të paraqitur në tabelën si vijon:

| NR. | INSPEKTORATET SHTETËRORE                                                           | MASAT ADMINISTRATIVE | MASAT DISIPLINORE |                                    |                                                                    | KALLËZIME PENALE |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|-------------------|------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|------------------|
|     |                                                                                    |                      | "Vërejtje"        | "Largime nga puna\shërbi mi civil" | "Mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6" |                  |
| 1   | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit , Drejtoria Rajonale Gjirokastrë                    | 4                    | 12                | –                                  | –                                                                  | –                |
| 2   | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit , Drejtoria Rajonale Lezhë                          | 16                   | –                 | 7                                  | 10                                                                 | 7                |
| 4   | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale Durrës -PIK                     | 5                    | 8                 | –                                  | –                                                                  | –                |
| 3   | Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial                                       | 5                    | 8                 | –                                  | –                                                                  | –                |
| 5   | Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Vlorë                            | 5                    | 5                 | –                                  | –                                                                  | –                |
| 6   | Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë | 8                    | 4                 | 9                                  | –                                                                  | –                |
| 7   | Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës | 10                   | 5                 | 7                                  | –                                                                  | 1                |

Tabelë: Të dhëna për rezultatet e kontrollit të Task Forcës Antikorrupsion.

### 1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

**Arritjet:** DPA, është inspektorati i cili ka realizuar me sukses planet e programuara për vitin 2018; ka kryer 100% të gjitha inspektimet në sistemin unik “e-inspektimi”; ka marrë pjesë në takimet dhe trajnimet e organizuara nga IQ, gjatë vitit për rritjen e performancës së inspektimeve dhe të inspektorëve si dhe konsultime në lidhje me zgjidhjen e problematikave që lindin për zbatimin ligjit për inspektimin gjatë veprimtarisë së tyre inspektuese.

DPA, ka tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Janë trajnuar 7 inspektorë për përdorimin e tabletave. Gjithashtu, IQ ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror me 14 tableta për kryerjen e inspektimeve online.



Figurë: Inspektime të realizuara nga DPA, për Vitin 2018.


**Problematikat:** nevoja për ndryshim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2013, "Për arkivat"; mungesa e kushteve të punës me mjete logjistike për kryerjen e inspektimeve me efektivitet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## 2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**Arritjet:** Gjatë vitit 2018, IKMT ka realizuar 0% inspektime në sistemin unik ‘e-inspektimi’. Ky inspektorat ka qenë përfshirë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga IQ, në lidhje me implementimin e inspektimeve online, por që nuk ka gjetur vullnet të plotë nga ky inspektorat për t’u realizuar. Për vitin 2019, IQ në bashkëpunim të ngushtë me këtë ISH, do të angazhohet për zbatimin e misionit të ngarkuar nga Qeveria Shqiptare për dixhitalizimin në themel të procedurave inspektuese në vend, në këtë drejtim do të evitojë nevojën e kryerjes së inspektimeve me modelin tradicional me blloqe, i cili është modeli që në të gjitha rastet do të konsiderohet si konsumim i hapur i elementëve të korrupsionit dhe paligjshmërisë dhe do të marrë masat e nevojshme ligjore për parandalimin e këtyre rasteve.

IKMT, ka tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 34 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit online. IQ ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror me 36 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.

Në kuadër të Task Forcës për vitin 2018, në IKMT janë vendosur 4 Masa administrative me “Largim nga puna”.




Figurë: Inspekte të realizuara nga IKMT, për Vitin 2018.

**Problematikat:** Ky inspektorat paraqet si problematikë nevojën për përmirësim të kushteve të punës sidomos mungesën e mjeteve të transportit si dhe pamjaftueshmëri në strukturë duke qenë se është i vetmi inspektorat i cili mbulon me veprimtari inspektuese të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### 3. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

**Arritjet:** ISHPSHSH, është inspektorati i cili i ka realizuar 100%, të gjitha inspekte në sistemin unik ‘e-inspektimi’. ISHPSHSH, ka tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar disa herë 98 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit online. IQ ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror me 50 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.

Në kuadër të Task Forcës për vitin 2018, në ISHPSHSH, janë vendosur 10 Masa administrative, 7 masa “Largim nga shërbimi civil”, 5 masa “Vërejtje” dhe 1 propozim për “Kallëzim penal”.




Figurë: Inspekte të realizuara nga ISHPSHSH, për Vitin 2018.

**Problematikat:** janë struktura e institucionit, si në aspektin organizativ të përcaktuar ashtu dhe në atë numerik të nëpunësve si dhe mosaksesimi i deklarimeve të subjekteve për punëmarrës, që fillojnë punën për herë të parë apo rishtas dhe që largohen nga skema “E-Sig 027”.

#### 4. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

**Arritjet:** ISHMT, 100% të inspektimeve të realizuara për 2018, i ka kryer në sistemin unik ‘e-inspektimi’. ISHMT, ka tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar disa herë 31 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit online. IQ, ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror me 20 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.



Figurë: Inspektime të realizuara nga ISHMT, për Vitin 2018.


**Problematikat:** Nevoja për mbështetje dhe rritje të rolit të juristëve me eksperiencë në proceset gjyqësore. Rritje e nivelit profesional për inspektorët nëpërmjet trajnimeve, për shkak të mungesës së eksperiencave të inspektimit në fushën përkatëse. Krijimi i një data basë të konsoliduar, i cili të realizojë planifikimin e inspektimeve me metodologji të vlerësimit të riskut. Qasje për ndërveprim pozitiv me institucionet kombëtare me përgjegjësi të përbashkët. Afatet e përgjigjeve të mostrave të mara për analizë paraqiten problematike. Miratimi i buxhetit vjetor për këtë Inspektorat, të ketë një normim bazuar në punën dhe aktivitetin e tij.

#### 5. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

**Arritjet:** ISHTI, ka kryer në sistemin online rreth 75% të inspektimeve të raportuara të realizuara për 2018 dhe 25% janë realizuar me formatin tradicional, me blloqe.

Gjatë vitit 2018, inspektorët e ISHTI kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar disa herë 30 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ. IQ, ka pajisur këtë inspektorat me 24 tableta për kryerjen e inspektimeve online.

Në kuadër të Task Forcës për vitin 2018, në AKU janë vendosur 5 Masa administrative dhe 8 Masa disiplinore “Vërejtje”.




Figurë: Inspekte të realizuara nga ISHTI, për Vitin 2018.

**Problematikat:** Nevoja për aftësim dhe ngritje të nivelit profesional të inspektorëve. Ndryshime strukturore me qëllim rritjen e numrit të inspektorëve dhe shërbimeve mbështetëse. Mungesë logjistike në automjete për të mbuluar veprimtarinë inspektuese, e cila shtrihet në të gjithë territorin e vendit dhe pikat doganore tokësore dhe detare. Nevojë për krijimin e ambienteve të punës për të gjithë sektorët e kësaj drejtorie. Kërkesë e vazhdueshme e këtij inspektorati është miratimi i ndryshimeve të propozuara në draft rregulloren e brendshme, e cila është e vitit 2010. Institucioni paraqet nevojë akute për pajisje laboratorike, për analizimin e lëkurëve dhe tekstileve.

#### 6. Autoritetit Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera

**Arritjet:** AKSEM, është inspektorati i cili e nisi kryerjen e veprimtarisë inspektuese në Korrik të 2018. Procedurat e inspektimit janë bërë edhe me blloqe, edhe nëpërmjet portalit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”. ISHPSHSH, ka tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullore nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 4 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit online. IQ ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror me 10 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.


**Problematikat:** Nevojë e vazhdueshme për trajnim të inspektorëve për përdorimin e sistemit unik ‘e-inspektimi’, duke qenë se implementimi veprimtarisë inspektuese online është implementuar në gjysmën e dytë të vitit 2018. Institucioni paraqet nevojë për përmirësim të kushteve të punës së inspektorëve jo vetëm në ndërtesë, por edhe në krijimin e kushteve me veshje të posaçme për kryerjen e inspektimeve në thellësi të tokës. Mungesë të mjeteve të transportit, duke qenë se përshkohen terrene të largëta dhe të vështira. Studim për planifikim të inspektimeve me metodologji të vlerësimit të riskut. Nevojë për rritje të numrit të inspektorëve (ekzistencë e vendeve vakante) dhe shërbimeve mbështetëse. Pagat e inspektorëve nuk justifikojnë vështirësitë dhe punën e kryer.



Figurë: Inspektime të realizuara nga AKSEM, për Vitin 2018

## 7. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor

**Arritjet:** DIH, është inspektorati i cili e nisi kryerjen e veprimtarisë inspektuese në Korrik të 2018. Procedurat e inspektimit janë bërë edhe me blloqe, edhe nëpërmjet portalit unik të inspektimeve “e-Inspektimi”. Gjatë vitit 2018, inspektorët e ISHTI, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. janë trajnuar 2 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit online. IQ, ka pajisur këtë inspektorat me 4 tableta për kryerjen e inspektimeve online.



Figurë: Inspektime të realizuara nga DIH, për Vitin 2018.


**Problematikat:** DIH, ka mungesë të burimeve njerëzore; nevojë për investim në infrastrukturën institucionale, logjistike për të krijuar sistem sa më konkurrent në tregun e transportit.

## 8. Inspektorati Shtetëror i Arsimit

**Arritjet:** Gjatë vitit 2018, me koordinimin dhe mbikëqyrjen e Inspektoratit Qendror, ISHA ka realizuar online 100% të inspektimeve të kryera dhe ka rritur transparencën, efektivitetin dhe

besueshmërinë e veprimtarisë inspektuese si dhe ka mundësuar inspektime dhe vendimmarrje në kohë reale në institucionet arsimore parauniversitare.

Gjatë vitit 2018 edhe inspektorët e ISHA, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ. Gjithashtu, janë trajnuar 7 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit, si një proces i rregullt administrative. IQ, ka pajisur këtë Inspektorat Shtetëror, me 7 tableta për kryerjen e inspektimeve online.



Figurë: Inspektime të realizuara nga ISHA, për Vitin 2018.

**Problematikat:** Nga 44 inspektimet e orientuara jashtë programit, 30 inspektime janë iniciuar në paligjshmëri, pa autorizimin me urdhër të posaçëm të Kryeinspektorit, por trupa inspektuese është autorizuar në mungesë kompetence, drejtpërdrejt me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.


## 9. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

**Arritjet:** AKU, ka kryer 51.2% të inspektimeve të realizuara për 2018 në sistemin unik të inspektimeve ‘e-inspektimi’, 48.7% të tyre nëpërmjet formatit tradicional me bllaqe. Edhe AKU për vitin 2018, renditet ndër inspektoratet jo me vullnet të plotë për të implementuar formatin transparent të inspektimeve online. AKU nuk ka raportuar për 2018 sipas formatit të miratuar nga IQ, por me të dhëna tabelare. IQ, ka evidentuar nga formati i raportimit; mungesë transparence për eksportet e kryera në vend; mungesë informacioni për certifikatat veterinarë të lëshuara nga AKU; mungesë informacioni për numrin e licencave të refuzuara nga AKU, me ato të miratuara, mungesë informacioni për numrin e inspektimeve të kryera referuar sistemit alert RASFF (Rapid Alert System for Food and Feed).

Inspektorët e AKU, të tre sektorëve të inspektimit në të 12 qarqet, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 80 prej tyre, për përditësimet e sistemit për përdorimin e tij nëpërmjet tabletës si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt

administrative. IQ ka pajisur AKU, me 100 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.

**Në kuadër të Task Forcës për vitin 2018**, në AKU janë vendosur 25 masa administrative dhe 20 masa disiplinore “Vërejtje”, 10 masa me mbajtje e 1/3 së pagës së plotë për gjashtë muaj dhe 7 kallëzime penale.




Figurë: Inspektime të realizuara nga AKU, për Vitin 2018.

**Problematikat:** Gjatë raportimit të analizës për punën e vitit 2018, u paraqitën disa problematika ku përmenden: rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të garantimit të sigurisë ushqimore, plotësimi i vendeve vakante, në bashkëpunim me DAP; kryerja e inspektimeve në formë të kundraligjshme me sistemin tradicional me blloqe për sektorët e inspektimit me OSH, OJSH, fitosanitar dhe sektorin e PIK; problematika në lidhje me nevojën për ndryshime ligjore; përmirësimin e Shërbimeve Laboratorike të AKU, që kryejnë aktivitet gjithëvjetor duke analizuar të gjitha llojet e mostrave që sillen nga inspektorët gjatë kontrolleve zyrtare; përmirësim të infrastrukturës gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese në PIK-e (Pikat e Inspektimit Kufitar).

Gjatë viti 2019, IQ në bashkëpunim me AKU, do të përgatisë dokumentet standarde të kontrollit zyrtar të kryer në PIK-e në import-eksport, për t’u implementuar në sistemin unik të inspektimeve ‘e-inspektimi’, me qëllim rritjen e transparencës dhe garantimit të sigurisë ushqimore në vend.

#### **10. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës**

**Arritjet:** DSHPA, gjatë 2018, ka realizuar 100% inspektime online. Gjatë vitit 2018 edhe inspektorët e DSHPA, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar e ritrajnuar, 20 inspektorë për njohjen me përditësimin e sistemit, pas shpërndarjes nga IQ pajisur me 10 tableta për kryerjen e inspektimeve online.




Figurë: Inspekte të realizuara nga DSHPA, për Vitin 2018.

**Problematikat:** mungesa e sistemit të monitorimit Blue Box, për monitorimin e mjeteve të peshkimit, i munguar prej 2 vitesh ka vështirësuar evidentimin e gjetisë së paligjshme të ushtruar prej subjekteve në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë; pa mundësi për monitorimin dhe kontrollin 24/7 orë e peshkarexhave në det; mungesë e vëzhguesve dhe monitoruesve për grumbullimin e të dhënave statistikore dhe informacioneve të tjera; mungesë të mjeteve motorike lundruese dhe automjete për kryerjen e inspektimeve në terren.

### 11. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

**Arritjet:** ISHSH, gjatë 2018, ka realizuar 100% inspekte online dhe raporton një sërë arritjesh si: minimizimi i situatave problematike shëndetësore intoksikacioneve alimentare; përmirësimi i kushteve higjieno sanitare në institucionet arsimore parashkollore e shkollore; ngritja e Task-Forcës për menaxhimin e sezonit turistik veror; marrja pjesë në grupin ndërinstitucional të punës, pranë Zyrës së Kryeministrit, në lidhje me problematikat dhe masat për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm; hartimi i listë-verifikimeve të reja dhe bashkëpunimi me Inspektoratin Qendror për hedhjen e tyre në portalin “e-Inspektimi”; bashkëpunimi ndër-institucional pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për lehtësimin e procedurave të kontrollit fitosanitar/veterinar në stacionin hekurudhor të Tuzit; Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe pjesëmarrja në takimet periodike të GNKM (Grupit Ndërinstitucional Kundër Krimit Mjedisor) për përmirësimin e legjislacionit dhe veprime konkrete në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesëmarrëse në luftën kundër krimit mjedisor. Inspektorët e ISHSH në 12 qarqet, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar e ritrajnuar 128 prej tyre, për përditësimet e sistemit për përdorimin e tij nëpërmjet tabletës si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrative. IQ ka pajisur AKU, me 61 tableta për kryerjen e inspektimeve online sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.

**Në kuadër të Task Forcës për vitin 2018,** në ISHSH Vlorë janë vendosur 5 masa administrative dhe 5 masa disiplinore “Vërejtje”, 10 masa me mbajtje e 1/3 së pagës së plotë për gjashtë muaj dhe 7 kallëzime penale.




Figurë: Inspektime të realizuara nga ISHSH, për Vitin 2018.

**Problematikat:** U paraqitën gjatë raportimit të Analizës së punës për 2018, ku u përmendën: nevoja për planifikimin e inspektimeve me metodologji të vlerësimit të riskut, duke vendosur prioritetet në orientimin e inspektimit që ka më shumë problematika; bashkëpunim ndërinstitucional për kryerjen e inspektimeve të përbashkëta me inspektorate, të cilët kanë të njëjtët operatorë biznesit si objekt kontrolli; mungesa e mjeteve infrastrukturore, sidomos të transportit; përmirësim të kuadrit ligjor për duhanin me qëllim vendosjen e masave administrative në formë progresive, për të njëjtën shkelje të konstatuar nga trupa inspektuese, përmirësimi dhe uniformizimi i pagave të inspektorëve për të gjithë inspektoratet.

## **12. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore**

**Arritjet:** AKBPM ka implementuar kryerjen e inspektimeve në sistemin unik ‘e-inspektimi’ në Korrik të 2018 dhe ka ushtruar veprimtarinë inspektuese në përputhje me udhëzimet, urdhrat dhe orientimet e Inspektoratit Qendror. Nga raporti për punën e kryer gjatë vitit AKBPM, nuk ka raportuar për inspektimet e planifikuara për vitin 2018. Ka realizuar 80% të inspektimeve online dhe vetëm 20% me format, me blloqe. Inspektorët e AKBPM, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 37 prej tyre për përditësimet e sistemit për përdorimin e tij nëpërmjet tabletës si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ. IQ ka pajisur AKU, me 7 tableta për kryerjen e inspektimeve online, sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.




Figurë: Inspekte të realizuara nga AKBPM, për Vitin 2018.

**Problematikat:** monitorimi në kohë reale i subjekteve farmaceutike, pa qenë pjesë aktive e procesit të licencimit. Licencimi i subjekteve farmaceutike me vetëdeklarim, efektivisht ka sjellë problematika në shërbimin farmaceutik në drejtim të mungesës së ofrimit të shërbimit nga stafi i kualifikuar dhe profesional i detyrueshëm sipas ligjit për barnat apo mos përmbushjes së praktikave të ruajtjes dhe tregtimit të mirë të barnave.

Përballë fenomeneve si, licencimi i subjekteve farmaceutike (farmaci dhe agjenci) duke patur të njëjtin drejtues teknik, në kundërshtim të plotë me ligjin e barnave, ushtrimi i aktivitetit farmaceutik të pa licencuar apo licencimi i farmacive "inekzistente" (që nuk janë aktive në treg), e bën të domosdoshme pjesëmarrjen e Agjencisë në procesin e verifikimit paraprak të subjekteve farmaceutike (farmaci/agjenci farmaceutike) që aplikojnë për licencim pranë QKL. AKBPM, mendon se duhet të ketë të drejtën të bëjë vlerësimin e subjekteve farmaceutike, nëse këto plotësojnë kushtet për ruajtjen e mirë të barnave dhe nëse kanë të pranishme pjesën më të madhe të barnave të detyrueshme, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

### 13. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

**Arritjet:** ZMR ka kryer 100% inspekte në sistemin online “e-Inspektimi”, në përputhje me ligjin nr.10433 datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizues. Inspektorët e AKBPM, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullore nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 4 prej tyre për përditësimet e sistemit për përdorimin e tij nëpërmjet tabletës si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrative. IQ ka pajisur ZMR, me 2 tableta për kryerjen e inspektimeve online, sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.




Figurë: Inspektime të realizuara nga ZMR, për Vitin 2018.

**Problematikat:** Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka përgatitur të gjithë anën ligjore në lidhje me procesin e inspektimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, proces i cili nuk ka nisur ende për arsye se ZMR-së nuk i janë vënë në dispozicion as pajisjet për matjen e rrezatimit jojonizues dhe as burimet njerëzore në mbështetje të këtij procesi dhe fillimi i inspektimeve të burimeve të rrezatimit jojonizues, është sfida kryesore për vitin 2019. ZMR, ka mangësi infrastrukturore në logjistikë dhe në drejtimin laboratorik si dhe nevojë për rritjen e numrit të inspektorëve dhe shërbimeve mbështetëse.

#### **14. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit**


**Arritjet:** Edhe ISHPMUT, gjatë 2018 është paraqitur si inspektorati i cili ka patur mungesë vullneti të implementimit të inspektimeve online, për këtë shkak nga grafika vihet re se vetëm 28.5% e inspektimeve është kryer në sistemin unik të inspektimeve ‘e-inspektimi’ dhe 71.4% e tyre janë të modelit të kundraligjshëm në mungesë transparence, atij me blloqe. Inspektorët e ISHPMUT, kanë tërhequr pranë IQ, broshurën e rregullores nr. 25 “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe kryer deklarinimin për zbatimin me përgjegjshmëri të saj. Gjithashtu, janë trajnuar 80 prej tyre për përditësimet e sistemit për përdorimin e tij nëpërmjet tabletës si dhe janë njohur me paraqitjen filmike të procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrative. IQ ka pajisur AKU, me 103 tableta për kryerjen e inspektimeve online, sipas parimit për çdo grup 3-5 inspektorë.



Figurë: Inspekte të realizuara nga ZMR, për Vitin 2018.

**Problematikat:** mungesë e planifikimit të inspektimeve bazuar në vlerësimin e metodologjisë së riskut; mungesë e kontrollit të vërtetësisë së të dhënave për normat e shkarkimeve në ajër pasi Strukturat e Ministrisë së Mjedisit (AKM, ISHMP dhe vetë MM) **nuk kanë laboratorë të akredituar**; nevojë për forcim të kapaciteteve institucionale nëpërmjet ristrukturimit; për përmirësim të listë-verifikimeve në portalin e-inspektimi dhe përdorimi me sukses të këtij portali për kryerjen 100% të inspektimeve online të planifikuara, për sa i përket zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e inspektimit në mjedis; nevojë për rritje të kapaciteteve teknike dhe logjistike për inspektorët, rritje të nivelit profesional të tyre, lidhur me ndryshimet e reja që priten të transpozohen në kuadër të përfarimit të legjislacionit me atë të BE. Mungesë në infrastrukturë dhe mjete transporti.

**Nga sa më sipër, realizimi i Planeve Vjetore të Inspektorateve Shtetërore, ka qenë siç paraqitet në tabelë:**



Figurë: Realizimi në %, i Planeve Vjetore në ISH

## VIII. INSPEKTIMET NË SISTEMIN “E-INSPEKTIMI”

Gjatë vitit 2018, Inspektorati Qendror ka drejtuar punën për dixhitalizimin e inspektimeve në të gjitha inspektoratet Shtetërore dhe Vendore.

Në këtë kuadër ka gjetur bashkëpunim pozitiv dhe të frytshëm me pushtetin Vendor, i cili tregoi përgjegjshmëri në këtë iniciativë për të përshkuar të gjithë hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Janë krijuar dhe implementuar në sistemin online, dokumentet standarde, listë verifikimet si dhe janë kryer trajnime me trupat inspektuese vendore për t'u njohur me përdorimin e sistemit elektronik të inspektimeve në tabletë.

Bashkia Tiranë si iniciatorja, ka filluar të kryej inspektimet online pasi ka tërhequr nga IQ, 92 tableta dhe është njohur dhe ka tërhequr edhe broshurën e rregullores nr. 25/2018, “Për kryerjen e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ”.

IQ, ka vijuar të kryej takime periodike me Kryeinspektorët e ISH, për t'i vendosur ata përpara përgjegjësisë së zbatimit të detyrimit ligjor për kryerjen e inspektimeve online, si misioni i IQ, për të patur veprimtari inspektuese sa më efektive dhe transparente në vend.

Këto takime kanë qenë të vlefshme pasi kanë bërë të mundur edhe verifikimin e problematikave të ndryshme që kanë patur inspektoratet jo vetëm me përdorimin e sistemit elektronik por edhe me vështirësi dhe problematika infrastrukturore, logjistike në Inspektoratet Shtetërore.

Kryerja e inspektimeve online nga inspektoratet Shtetërore ka sjellë mbikëqyrjen më efektive të inspektimeve nga ana e IQ, gjë e cila bën të mundur evitimin e kontrolleve të cilat janë të paprogramuara, për rrjedhojë kjo ka çuar në uljen e inspektimeve të paprogramuara në disa inspektorate.

Gjatë këtij viti, Inspektoratet Shtetërorë, DPA, ISHPSHSH, ISHMT, ISHTI, ISHA, DIH, DSHPA, ISHSH, ZMR, kanë evituar totalisht inspektimet me blloqe dhe i programojnë ato bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut.

Për vitin që vjen IQ, do të fokusohet në implementimin plotësisht të inspektimeve online edhe në inspektoratet e tjera Shtetërore dhe Vendore.


Nga rezultatet e arritura dhe raportuara në analizat e Inspektorateve Shtetërore, veprimtaria e inspektimeve të kryera në vend, për vitin 2018 përbën, 74% të inspektimeve të kryera në sistemin unik ‘e-inspektimi’ dhe vetëm 26 % të kryera më formatin e kundraligjshëm me blloqe. Për realizimin e inspektimeve në sistemin unik të inspektimeve gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim Inspektorati Qendror ka **shpërndarë 448 tableta** Inspektorateve Shtetërore dhe **92 tableta** Inspektoratit Vendore. IQ, ka shpërndarë gjatë viti 2018, grupeve të interesit (inspektorë, dhomave të tregtisë etj.), **800 copë broshura** të rregullores nr. 25/2018, “Për kryerjen e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ” dhe për zbatimin e saj, ka pajisur **769 inspektorë**. Për përdorimin e sistemit të përditësuar, janë trajnuar **564 inspektorë** shtetërorë dhe është në proces të trajnimit të inspektorëve vendore, me qëllim zbatimin me përgjegjshmëri të rregullores për inspektimin, për të rritur profesionalizmin dhe transparencën në inspektime dhe minimizuar fenomenin e korrupsionit.

| Inspektoratet      | DPA | IKMT | ISHPSH SH | ISHMT | ISHTI | AKSEM | ISHA | DIH | AKU | DSHV | DSHPA | ISHSH | AKBPM | ZMR | ISHMP UT | Totali |
|--------------------|-----|------|-----------|-------|-------|-------|------|-----|-----|------|-------|-------|-------|-----|----------|--------|
| Nr. Inspektorë     | 22  | 22   | 97        | 48    | 68    | 13    | 17   | 0   | 274 | 0    | 21    | 235   | 23    | 9   | 354      | 1203   |
| Rregullore         | 14  | 106  | 110       | 44    | 35    | 13    | 17   | 13  | 170 | 0    | 21    | 141   | 1     | 9   | 75       | 769    |
| Tableta            | 14  | 36   | 50        | 20    | 24    | 10    | 7    | 4   | 100 | 0    | 10    | 61    | 7     | 2   | 103      | 448    |
| Trajnime/disa herë | 9   | 34   | 98        | 31    | 30    | 4     | 7    | 2   | 80  | 0    | 20    | 128   | 37    | 4   | 80       | 564    |

Në sistemin elektronik “e-Inspektimi”, **gjatë vitit 2017 janë kryer 13.444 inspektime**, ndërsa **për vitin 2018, janë kryer 69 810 inspektime online**, tregues i cili paraqet prirjen pozitive të futjes së veprimtarisë së inspektimeve në drejtimin ligjor, duke rritur kështu nivelin e transparencës duke siguruar përpunimin më të saktë të të dhënave nga IQ për veprimtaritë inspektuese në vend.

| INSPEKTORATI | Jashte Programit                                  |                                                |                                                         |                                                       | Te Programuara                                 |                                             |                                                      |                                                    |        |
|--------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|------------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|--------|
| INSPEKTORATI | Nr. i çështjeve të pa planifikuara të përfunduara | Nr. i çështjeve të pa planifikuara në progress | Nr. i çështjeve të pa planifikuara me status të anuluar | Nr. i çështjeve të pa planifikuara me status të hapur | Nr. i çështjeve të planifikuara të përfunduara | Nr. i çështjeve të planifikuara në progress | Nr. i çështjeve të planifikuara me status të anuluar | Nr. i çështjeve të planifikuara me status të hapur | Totali |
| AKU          | 2879                                              | 114                                            | 320                                                     | 39                                                    | 8866                                           | 290                                         | 671                                                  | 1430                                               | 14609  |
| ISHPSHSH     | 1508                                              | 18                                             | 135                                                     | 2                                                     | 12207                                          | 43                                          | 230                                                  | 99                                                 | 14242  |
| AKBPM        | 375                                               | 25                                             | 49                                                      | 8                                                     | 109                                            | 36                                          | 6                                                    | 19                                                 | 627    |
| AKSEM        | 3                                                 | 37                                             | 1                                                       | 3                                                     | 523                                            | 18                                          | 32                                                   | 0                                                  | 617    |
| DIH          | 70                                                | 1                                              | 9                                                       | 0                                                     | 12                                             | 0                                           | 16                                                   | 0                                                  | 108    |
| DPA          | 5                                                 | 1                                              | 2                                                       | 1                                                     | 145                                            | 4                                           | 16                                                   | 2                                                  | 176    |
| DSHPA        | 756                                               | 8                                              | 64                                                      | 0                                                     | 217                                            | 0                                           | 10                                                   | 0                                                  | 1055   |
| DSHV         | 1                                                 | 23                                             | 0                                                       | 11                                                    | 0                                              | 0                                           | 0                                                    | 0                                                  | 35     |
| ISHA         | 47                                                | 0                                              | 10                                                      | 0                                                     | 90                                             | 0                                           | 10                                                   | 0                                                  | 157    |
| ISHMT        | 151                                               | 13                                             | 51                                                      | 7                                                     | 2013                                           | 19                                          | 157                                                  | 199                                                | 2610   |
| ISHPMUT      | 331                                               | 132                                            | 93                                                      | 26                                                    | 1462                                           | 155                                         | 212                                                  | 167                                                | 2578   |
| ISHSH        | 6664                                              | 148                                            | 305                                                     | 36                                                    | 19338                                          | 370                                         | 1096                                                 | 678                                                | 28635  |
| ISHTI        | 2                                                 | 0                                              | 1                                                       | 26                                                    | 3825                                           | 324                                         | 103                                                  | 23                                                 | 4304   |
| ISHU         | 0                                                 | 5                                              | 0                                                       | 1                                                     | 0                                              | 0                                           | 0                                                    | 0                                                  | 6      |
| ZMR          | 0                                                 | 1                                              | 0                                                       | 0                                                     | 49                                             | 0                                           | 0                                                    | 1                                                  | 51     |
| Totali       | 12792                                             | 526                                            | 1040                                                    | 160                                                   | 48856                                          | 1259                                        | 2559                                                 | 2618                                               | 69810  |

Tabelë 1: Të dhënat e inspektimeve në Sistemin ‘e-inspektimi’



Figurë: Treguesi i prirjes në rritje të numrit të inspektimeve të realizuara nga Inspektoratet Shtetërore, në sistemin unik “e-inspektimit”.

Nga përmbledhja e Raporteve Vjetore të Inspektorateve Shtetërore nga 82 863 inspektime të realizuara, 61 996 inspektime<sup>1</sup> janë kryer në sistemin unik të inspektimeve “e-inspektimi”.



*Figurë: Inspektime të realizuara online, për Vitin 2018.*



*Figurë: Të dhëna tabelare të sistemit 'e-inspektimi'*

Nga të dhënat tabelare, rezulton se rreth 77% e procedurave të inspektimit të Inspektorateve Shtetërore, është kryer e programuar dhe 23% e tyre është kryer jashtë programit.

## IX. NDRYSHIMET E PROPOZUARA TË LIGJIT PËR INSPEKTIMIN

Gjatë veprimtarisë së punës tonë, duke u fokusuar tek misioni ynë, kemi patur objektiva të qarta në lidhje me standardet që duhet të kenë Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore në vend, si dhe duke qenë faktori kyç, që njeh nga afër të gjitha problematikat dhe nevojat për përmirësim të tyre, është parë e nevojshme ndërhyrja dhe përmirësimi i ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”.

<sup>1</sup> Ka mospërputhshmëri në nr. e inspektimeve të kryera online, referuar raportimeve të ISH-ve me të dhënat e administruara nga IQ, në sistemin “e-inspektimi”, pasi ISH nuk kanë raportuar edhe numrin e çështjeve me status të hapur dhe atyre në progres, sipas Tabelës 1: Të dhënat e inspektimeve në Sistemin ‘e-inspektimi’.

Vizioni ynë, ka qenë në kuadër të zbatimit të Programit Qeverisës 2017-2021; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 si dhe Angazhimit të Qeverisë Shqiptare në Samitin e Londrës, Korrik 2018.

### **1. Përkufizimi i Problemit**

Në fillim u përkufizuan problematikat të cilat konsistojnë në:

Ekzistencën e konfliktit të ushtrimit të kompetencave në mes të nivelit qendror/lokal dhe atij ministror, megjithëse fushë veprimtaria e inspektorateve rregullohet me ligje të veçanta, në praktikë janë hasur pengesa të shumta mes inspektorëve të nivelit qendror dhe atyre lokal.

1. Mungesën e transparencës, efikasitetit të trupave inspektuese, ekzistencën e barrës administrative ndaj biznesit, të cilat janë hallka korruptive gjatë procesit të inspektimeve të të gjitha fushave, në Republikën e Shqipërisë.
2. Mungesën profesionalizmit, në ushtrimin e kompetencave me qëllim arritjen e objektivit, të Inspektorateve Shtetërore në Republikën Shqipërisë, atë të formalizimit të biznesit.
3. Ushtrimin e veprimtarisë inspektuese, në mungesë të pavarësisë në vendimmarrje të trupës inspektuese si dhe nën ndikimin interferues politik, gjë e cila ka sjellë dhe realizim procedurash inspektuese në paligjshmëri si dhe në konsumim të hapur veprimesh korruptive.
4. Kapacitetet institucionale, infrastrukturore të pamjaftueshme në, burime njerëzore, logjistike dhe kapacitete laboratorike, të cilat janë domosdoshmëri për të forcuar funksionin e inspektimit, monitorimit të zbatueshmërisë së kuadrit rregullator nga bizneset dhe jo vetëm.
5. Kërkesa ligjore të njëjta nga më shumë se një inspektorat, duke çuar edhe në mbivendosje të veprimtarisë inspektuese.
6. Shqyrtimin e ankimimit në Inspektoratin Shtetëror, i cili licencon, programon, planifikon, inspekton, Operatorin e Biznesit dhe në të njëjtën kohë kryen dhe shqyrtimin e ankimimit, gjë që çon në konsumimin nga trupa kolegjiale të elementëve korruptivë dhe vendosjen e subjektit nën presion administrativ.

Në këtë kuadër, është parë e nevojshme ndërhyrja e Qeverisë, sepse pa këtë ndërhyrje, situata e inspektimeve në vend, do të vazhdojë të jetë e përfshirë në kushte jo të përshtatshme infrastrukturore në inspektorate, me inspektorë të pakualifikuar, me emërimet nepotike, jo profesioniste, pa meritokraci dhe sistem karriere si dhe nën interferencat e ministrive përgjegjëse.

### **2. Objektivat**

Objektivat dhe efektet e synuara të propozimit janë me qëllimin që:

- ✓ të garantohet pavarësia funksionale e Inspektorateve me efektin e ndarjes së politikë-bërjes nga procesi i inspektimit;

- ✓ të menaxhohen dhe koordinohen më mirë Inspektoratet Shtetërore, duke qenë se riorganizohen në më pak inspektorate;
- ✓ të ruhet numri ekzistues i inspektorëve në inspektorate, të pa ndryshueshëm;
- ✓ të ulet numri inspektimeve aktuale, duke qenë se trupat inspektuese organizohen nga trupa me 1 - 2 inspektorë, në trupa inspektuese me 3 - 5 inspektorë;
- ✓ të ulet numri i inspektimeve në Operatorët e Biznesit, nga 184 217 inspektime/vit, në 47 610 inspektime/vit, pra parashikohen të realizohen ~ 74% e inspektimeve më pak, ulje e cila do të thotë: ulje e barrës administrative, ulje të kostos në kohë/orë inspektimi pranë bizneseve, rritje cilësore e procedurës së inspektimit;

### 3. Ndikimet

Ndryshimi i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, shkon paralel edhe me riorganizimin dhe konsolidimin e trupave inspektuese në Inspektorate, me vullnetin për t’i zbatuar procedurat e inspektimit dhe aktivitetet laboratorike, më me efektivitet, eficiencë dhe ekonomi.

**Përmirësimet cilësore**, në veprimtaritë inspektuese do të garantojnë inspektime me standarde bashkëkohore, me trupa inspektuese profesionale, me kushte më të mira pune, që ushtrojnë parimet bazë të ndryshuara në ligjin për inspektimin.

Kërkesat ligjore që do të çojnë në **ofrim të shërbimeve ndaj Operatorëve të Biznesit me standarde bashkëkohore**, i janë referuar modeleve dhe praktikave më të mira të marra nga bashkëpunimi me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës, modele të cilat kanë çuar në propozimin e opsioni preferencial.

- a) **do të evitohen, anshmëritë, dublikimet** dhe mbivendosjet, në procedurat inspektuese, duke reduktuar numrin ekzistues të inspektimeve.
- b) do të sigurohet, **rritje cilësore e kapaciteteve kontribuese institucionale** si dhe e integritetit të trupave inspektuese nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar bazuar në sistemin e karrierës.
- c) **do të evitohet fryrja e strukturave** të sektorëve mbështetës në Inspektorate, drejtori agjenci.
- d) do të sigurohet një **menaxhim më me efektivitet, eficiencë, dhe ekonomi** të fondeve publike. Një planifikim dhe menaxhim i mirë i fondeve publike do të sjellë ulje të riskut në sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemet e pagesave, sistemet e prokurimeve, sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, dhe sistemet e programimit dhe zbatimit të buxhetit.

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar”, do të autorizojë miratimin e vendimeve të caktuara të Këshillit të Ministrave, të cilat do të mundësojnë zbatimin e tij, nga institucionet zbatuese të vartësisë.

Inspektorati Qendror, do të monitorojë zbatimin e ligjit për inspektimin, si dhe akteve nën ligjore që do të parashikohen në zbatim të tij.


## X. FAQJA ZYRTARE E INSPEKTORATIT QENDROR

Në zbatim të pikës h, të nenit 16, të kreut III, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati Qendror ka përditësuar periodikisht Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë dhe Vendorë në detyrë, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al) dhe e gjithë trupa inspektuese shtetërore është e pajisur me kartën e inspektorit.

Në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, ofrohet informacion për bizneset dhe qytetarët në lidhje me Listë Verifikimet e Inspektorateve Shtetërore, në të cilat ka informacion për kërkesat ligjore të të gjitha fushave të inspektimit, të cilat janë detyrim ligjor për t’u përmbushur nga të gjithë operatorët ekonomik.

Gjithashtu, ka informacion për të gjitha aktivitetet, zhvillimet dhe ecuritë në veprimtarinë tonë, ku pjesë janë edhe ndryshimet ligjore të propozuara, për të qenë koherent dhe transparent me qytetarët dhe bizneset.

Faqja jonë zyrtare, ka ofruar shërbim për të gjithë qytetarët dhe bizneset, për trajtimin e ankesave të ndryshme, të cilat kanë qenë në kompetencë institucionale tonën. Gjatë vitit 2018, IQ ka shqyrtuar dhe kthyer përgjigje për 65 raste.



*Figurë: Ankimimet e shqyrtuara*

## XI. KOMENTE

Nga raporti, njihemi me faktin se procedurat e inspektimit nga Inspektoratet Shtetërore dhe zbatueshmëria e ligjit për inspektimin është përmirësuar edhe duke marrë parasysh hartimin e rregullores nr. 25, datë 10.08.2018, “Për kryerjen e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ”.

Aktivitetet e organizuara nga IQ, kanë dhënë efektet e veta edhe duke marrë parasysh trajnimet e njëpasnjëshme të inspektorëve dhe paraqitja e rregullores së inspektimit edhe me pamjet filmike, për t’u bërë sa më e perceptueshme për zbatim nga të gjithë trupat inspektuese.

Pajisja e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore me **tabletë**, është një tjetër hap përmirësues në veprimtaritë inspektuese, pasi i vjen në ndihmë inspektorëve duke u a thjeshtuar dhe bërë

më komod procesin. Ky përmirësim duket ndjeshëm, jo vetëm për veprimtarinë e inspektorëve, por edhe të biznesit, duke rritur nivelin e transparencës dhe efektivitetit në procesin e inspektimit.

Ka Inspektoratet Shtetërore, që ende nuk kryejnë programin e veprimtarisë së tyre inspektuese, vjetor/mujor, në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut, si një metodë bashkëkohore me qëllim parandalimin e risqeve në të gjitha fushat e inspektimit, të cilat kanë impakt të ndjeshëm në ambientin rrethues dhe interesat e publikut.

Përmirësimet e arritura në fushën e inspektimeve, gjatë këtij viti do të arrijnë rezultate pozitive, pasi puna e tyre t'i përafrohet maksimalisht modeleve të praktikave më të mira të BE dhe parimeve të OECD, në fushën e inspektimeve.

Referuar këtyre praktikave dhe parimeve, ndryshimet e propozuara në ligjin për inspektimin, priren të përmirësojnë shumë problematika, të cilat janë evidentuar gjatë studimit të objektit të punës në Inspektoratet Shtetërore, si: kapacitete institucionale të pamjaftueshme; mungesë të kushteve të punës; mungesë të mjeteve logjistike; mungesë për pajisje dhe materiale laboratorike; trupa inspektimi, të pa kualifikuara, pa arsimin përkatës; të cilat sjellin mungesë të monitorimit të zbatueshmërisë së kuadrit rregullator nga bizneset dhe jo vetëm.

Gjithashtu, nivel të ulët page për inspektorin; mungesë transparence gjatë veprimtarisë së inspektimit në subjekt; kryerje e një numri të konsiderueshëm inspektimesh të paprogramuara; kryerje inspektimesh të pabazuara në metodologji dhe vlerësim risku; mungesë në vendimmarrje të trupës inspektuese, për efekt të interferencës politike; inspektime të dublikuara me kërkesa ligjore të njëjta nga Inspektoratet Shtetërore të ndryshme; ushtrimi i veprimtarisë inspektuese nga një inspektor i vetëm; veprimtaria inspektuese e Inspektorateve Shtetërore, kryhet jo konform kërkesave ligjore; procedurat rregullatore të tilla si: regjistrimi, licencimi apo marrja e lejeve, si të drejta për ushtrimin e një aktiviteti të caktuar nga Operatorët e Biznesit, kryhen nga e njëjta strukturë institucionale duke krijuar situatë në konflikt interesi; marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve me dy standarde (me kod pune dhe status i nëpunësit civil); për Vitin 2018, mbi 50% të Vendimeve Administrative, janë shfuqizuar nga trupat kolegjiale pranë Inspektorateve Shtetërore dhe 75% e Vendimeve Administrative të lëna në fuqi, janë shfuqizuar në gjykatë; Inspektoratet Shtetërore, nuk kanë marrë masa disiplinore ndaj inspektorëve, me Vendime Administrative të shfuqizuara; shqyrtim i ankimit të subjektit, nga trupë kolegjiale brenda organit, i cili ushtron kontrollin ligjor në subjekt.

Të gjithë këta faktorë, kanë ndikuar në ushtrim të kompetencave administrative, inspektuese në paligjshmëri, në formë permanente, duke u bërë për Operatorët e Biznesit, barrë administrative dhe hallkë korruptive gjatë inspektimeve të të gjitha fushave në Republikën e Shqipërisë.

Për propozimet për ndryshim në ligjin për inspektimin IQ, ka organizuar aktivitete të vazhdueshme për njohjen e publikut dhe grupeve të interesit dhe po vijon t'a ofrojë, me qëllim përgatitjen e tyre me ndryshimet e kryera si dhe marrjen më tej të mendimeve, të cilat do të konsiderohen konstruktive për të arritur objektivin e Qeverisë me fokus, përmirësimin e klimës për biznesin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin.

Ndryshimet ligjore, do të shtojnë seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e inspektorateve në zbatim të akteve ligjore, nënligjore në fuqi dhe ushtrimin e veprimtarisë inspektuese bazuar në parime, duke rritur transparencën dhe ulur nivelin e korrupsionit në këtë fushë.

## XII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

Në kuadër të përmbushjes së gjithë aktivitetit të Inspektoratit Qendror, buxheti i institucionit është shpenzuar për kryerjen e detyrave funksionale të këtij institucioni. Plani i buxhetit të vitit 2018, i miratuar nga Ministria e Financave, me ligjin nr. 109/ 2017, për Inspektoratin Qendror, ka qenë 65 977 788 lekë në total dhe i detajuar sipas zërave më poshtë:

**000 / lekë**

| BUXHETI I VITIT 2018 |                                                      |               |               |                     |                          |
|----------------------|------------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------------|--------------------------|
| Nr.                  | Emërtimi i zërave të shpenzimeve                     | Plani 2018    | Fakti 2018    | Diferenca Plan/Fakt | Realizimi i buxheti në % |
|                      |                                                      |               |               |                     |                          |
| 1                    | Paga, shpenzime të tjera personeli                   | 26 780        | 21 359        | 5 421               | 79.76%                   |
| 2                    | Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 3 563         | 3 383         | 180                 | 94.94%                   |
|                      |                                                      |               |               |                     |                          |
| 3                    | Mallra, shërbime dhe shpenzime të tjera operative    | 14 589        | 12 689        | 1 900               | 86.98%                   |
| 4                    | Investime                                            | 24 016        | 24 016        | 0                   | 100%                     |
|                      | <b>TOTALI</b>                                        | <b>65 978</b> | <b>61 447</b> | <b>4 531</b>        | <b>93.13%</b>            |

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të planit të miratuar të shpenzimeve buxhetore për Inspektoratin Qendror, e zënë zërat e shpenzimeve për Paga, shpenzime të tjera personeli, dhe Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të cilat kanë një peshë specifike prej 45.98%, kundrejt totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa fondi i investimeve zë një vend relativisht më të vogël kundrejt periudhave të mëparshme buxhetore.

Buxheti vjetor i vitit 2018, u realizua sipas akteve ligjore ekonomiko-financiare në fuqi për të gjitha zërat e tij.

Zëri i buxhetit 231 “Investime”, i cili ishte me një vlerë totale prej 24 015 900 lekë, u realizua në masën 100 %. Pjesën më të madhe e zë “Upgrade i sistemit e-Inspektimi”, në kuadër të reformimit të inspektorateve shtetërore, në vlerën 14 341 900 lekë (blerje tableta për inspektimin online). Zëri i dytë me peshë është shërbimi “Mirëmbajtje e sistemit e-Inspektimi” të Inspektoratit Qendror, në vlerën 9 450 000 lekë, që do të jetë kontratë në vazhdimësi. Procedura e prokurimit për këto dy zëra janë realizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Gjithashtu, për të gjitha procedurat e prokurimit është zbatuar Ligji i Prokurimit Publik.

I gjithë buxheti i miratuar për vitin 2018, u realizua në masën 93.13 % të fondit të miratuar për t'u shpenzuar për këtë periudhë.

Inspektorati Qendror, për vitin 2019 ka hartuar një buxhet realist, i cili do të lejojë të kryejë në kohë të gjitha aktivitetet e planifikuara, për përmbushjen e misionit të tij.

### **XIII. REKOMANDIME**

Inspektorati Qendror, ka kryer analizën e aktiviteteve të Inspektorateve Shtetërore për vitin 2018 dhe rekomandon si vijon:

- të realizohen inspektimet online për të gjitha Inspektoratet Shtetërore.
- të kryhen programet vjetore të inspektimit me metodologji të analizës së riskut edhe nga Inspektoratet të cilat nuk e aplikojnë atë, në zbatim të urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- të shmanget kategorikisht formati i inspektimit tradicional me blloqe për Inspektoratet që e aplikojnë atë.
- të unifikohet formati i raportimit të të dhënave nga Inspektoratet Shtetërore për pasqyruar efektivisht analizën vjetore të Inspektoratit Qendror.
- të ndiqen nga juristi i inspektoratit Qendror, proceset gjyqësore të vendimeve të “komisionit të ankimit” të ankimuara nga subjektet e ndëshkuara me masë administrative, në të gjitha Inspektoratet Shtetërore.
- të zbatohet rregullorja nr. 25, datë 10.8.2018, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ”.
- të monitorohet dhe të suportohet me trajnime dokumentimi dhe ngarkimi në sistemin online “e-Inspektimi”, nga sekretari dhe juristi i Trupës Kolegjiale, për të gjitha etapat e shqyrtimit të procedurës së ankimit nga Trupa Kolegjiale e Inspektorateve Shtetërore.
- të monitorohet dërgimi në kohë i listave dhe informacionit të përgjithshëm të inspektorëve shtetërorë në detyrë/larguar, të dërguara nga inspektoratet shtetërore me qëllim mbajtjen e përditësuar të Regjistrit Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë.
- të realizohet ndryshimi i propozuar për ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- të kryhet riorganizimi i trupave Inspektuese Shtetërore sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese.
- të shmanget mbivendosja e kompetencave ligjore të ushtruara në subjekt nga më shumë se një Inspektorat Shtetëror;
- të rregullohen marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve në Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë dhe akteve nënligjore, që përcaktojnë kushtet dhe kriteret profesionale të rekrutimit dhe të karrierës, për institucionet e pavarura.
- të rritet niveli i performancës dhe profesionalizmit të inspektorëve;
- të rritet vullnetin për t'i zbatuar më me efektivitet procedurat e inspektimit;
- të evitohen anshmërinë në vendimmarrje gjatë veprimtarisë së inspektimit;

- të minimizohet konsumimi i elementëve korrupsivë nga trupa inspektuese si dhe nga trupa kolegjiale e shqyrtimit të ankimimit të subjektit;
- të ulet barra administrative ndaj Operatorëve të Biznesit, gjatë procesit të inspektimeve;
- të kryhet testimi fillestar dhe periodik i inspektorëve shtetërorë dhe vendorë për aftësimin profesional në punë;
- të kryhet trajnimi, kualifikimi dhe certifikimi i inspektorëve, duke bashkërenduar me inspektoratet shtetërore dhe vendore;
- të rregullohet shqyrtimi i ankimimit ndaj vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit të Inspektorateve Shtetërore, që kryhet pranë Trupës Kolegjiale të Inspektoratit të Përgjithshëm Shtetëror të Ankimimeve Administrative.
- të përditësohen rregulloret dhe sidomos ato teknike të inspektorateve shtetërore.
- të rishikohet baza ligjore e mbivendosur e Inspektorateve Shtetërore, duke bërë ndarjen e kompetencave .
- të organizohen inspektime të përbashkëta me koordinimin e Inspektoratit Qendror, me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- të publikojnë të dhënat e veprimtarisë së tyre për të rritur transparencën ndaj publikut të gjitha Inspektoratet shtetërore
- të mundësohet prezenca e suportit teknik në inspektoratin Qendror si dhe në Inspektoratet Shtetërore me qëllim bashkëpunimin zinxhir për zgjidhjen në kohë reale të problematikave që lindin gjatë përdorimit të sistemit unik të inspektimeve me tableta;
- të ushtrohet mbikëqyrje dhe suport teknik për inspektoratet, të cilat nuk kryejnë inspektimin online;
- të mbështeten nga IQ, periodikisht problematikat në lidhje me përdorimin e sistemit elektronik “e-inspektimi”, gjatë kryerjes së inspektimit online nga trupat inspektuese;
- të informohet publiku nga faqet zyrtare të Inspektorateve Shtetërore për aktivitet dhe problematikat, të cilat kanë ndikim në jetën dhe shëndetin e qytetarëve;
- të vazhdojë misioni i IQ, për informimin e biznesit dhe qytetarëve për të gjitha aktivitetet, ndryshimet ligjore të propozuara dhe/ose të miratuara, për të qenë transparent dhe efektiv për detyrimet që i lindin atyre për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.

#### **XIV. KONKLUZIONE**

Të gjitha aktivitetet inspektuese në Republikën e Shqipërisë, do të kenë përmirësim cilësor në zbatueshmërinë ligjore të fushave përkatëse të inspektimit, për të gjitha Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore, me përgjegjësi të lartë dhe profesionalizëm, nëse do të mbikëqyren dhe koordinohen nga Inspektorati Qendror të organizuara në inspektorate me natyrë inspektimi të përbashkët.

Është shumë i rëndësishëm hapi në të cilin me punën tonë dhe në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë në fushën rregullatore inspektuese, kemi çuar situatën e inspektime në vend dhe po këtë rëndësi merr zhvillimi më tej i saj për të arritur standardet që aderon Qeveria jonë. Tashmë, vetëm ndryshimet e propozuara të ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, do t’i japin mundësi Inspektoratit Qendror të arrijë me nivel të lartë

të gjithë objektivat e ndërmarra, për vitin 2019 dhe për të gjithë veprimtarinë inspektuese në Republikën e Shqipërisë, mundësinë për të mbyllur kapitullin e abuzivizmit, barrës ekonomike për subjektet dhe shkëputjen e hallkës korruptive të trupave inspektuese.

Zbatueshmëria e të gjitha inspektimeve, pa përjashtim nga Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore në sistemin unik “e-Inspektimi”, është një arritje e cila synohet të zhvillohet nga Inspektorati Qendror, duke u pasuar më tej me ngritjen e performancës së inspektorëve, duke përmirësuar kushtet e punës dhe shpërblimin e duhur ekonomik për punën e kryer si dhe ndërtimin e karrierës së tyre.

Riorganizimi i inspektorateve në një ndërtesë të madhe do të zgjidhë të gjitha problematikat e shënuara në Inspektoratet Shtetërore.

Detyrimi ligjor i IQ, për përmirësimin e mëtejshëm të situatës së inspektimit dhe arritjen e objektivave të synuara, do të arrihen me komunikim të vazhdueshëm ndërinstitutional me të gjithë aktorët e kësaj reforme.



INSPEKTORATI QENDROR

*Adresa: Rruga Frosina Plaku, Godina e observatorit, Kati 0.*

*Tel.: 042 229765, Fax.: 042 228983. [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al)*

TIRANË, 2018